

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5957
E mërkurë, 18 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Se kush do të jetë president i Kosovës vendos opozita e jo pozita! F. 8

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PAL LEKAJ

INTERESAT E NGUSHTA TË LV-së DHE TË LDK-së MUND TA ÇOJNË VENDIN NË ZGJEDHJE



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), aktualisht ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka thënë se pazaret personale të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë


duke e penguar arritjen e marrëveshjes për krijimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto interesa të këtyre dy subjekteve politike mund ta çojnë vendin në

zgjedhje të reja. Sipas Lekajt, një gjë e tillë do të ishte dëshpëruese për qytetarët. Ai ka ftuar LV-në dhe LDK-në ta shikojnë interesin kombëtar dhe të heqin dorë nga interesat e ngushta partiake dhe t'i formojnë institucionet e reja

OPINION

NDRYSHIMET KLIMATIKE NUK KANË NEVOJË PËR VIZË SHENGEN F. 11

Nga Majlinda BREGU



AKTUALE

NDAHEN MBI 2 MILIONË EURO PËR POLICINË E KOSOVËS F. 6

AMBASADORI BRITANIK SHPALLET MIK NDERI I GJIMNAZIT 'HAJDAR DUSHI' NË GJAKOVË F. 6

EKONOMI

QEVERIA SHPRONËSON PRONAT PËR NDËRTIMIN E 'PARKUT TË BIZNESIT' F. 9

AVOKATI I POPULLIT: KEMI PRANUAR VENDIMIN E KUSHTETUESËS PËR PEZULLIMIN E LIGJIT PËR PAGA F. 9

KULTURË

U PROMOVUA LIBRI 'BALADË MUHAXHIRE' I AUTORIT NIMON MUÇAJ F. 14

SPORT

KLUBET E SUPERLIGËS FILLOJNË LËVIZJET PËR PRANVERË F. 20

Reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të qeverisjes së ardhshme



Demokracia në Veprim (DnV) ka mbajtur të martën tryezën "Procesi zgjedhor 2019: Mësimet e mësuara dhe rruga përpara", në të cilën është publikuar raporti përfundimtar i vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit dhe raporti i monitorimit të mediave gjatë fushatës elektorale të

këtyre zgjedhjeve. Në këtë tryezë janë diskutuar të gjeturat kryesore dhe rekomandimet që dalin nga këto raporte, si dhe është theksuar domosdoshmëria e përmbylljes së procesit të reformës zgjedhore, si parakusht për tejkalimin e sfidave të evidentuara në këto zgjedhje

Punimet për ndërtimin e Spitalit Pediatrik-Kirurgjik janë në fazën finale



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Batatina
Perfekta
BATATINA
Yekta
Perfekta
BATATINA
Perfekta
BATATINA
Perfekta

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net

Sa është reale kriza mes partnerëve të koalicionit LSDM-BDI?

Kriza mes partnerëve të koalicionit qeverisës LSDMS-së dhe BDI-së, u provokua pas dorëzimit të pesë mijë amendamenteve të partisë shqiptare në pushtet bashkë me një mijë amendamentet e VMRO DPMNE-së lidhur me ndryshimet e Kodit Zgjedhor

SHKUP, 17 DHJETOR - Njohësit e çështjeve politike në Maqedoninë e Veriut, thonë se është bërë e zakonshme që gjithmonë para mbajtjes së zgjedhjeve, partnerët e koalicionit qeveritar t'i ashpërsojnë raportet mes veti, për të treguar para elektoratit se kush është mbrojtës më i denjë i interesave të tyre, por thonë se është shumë e shkurtër koha prej 50 ditëve deri në shpërbërjen e Parlamentit që të testohet realisht koalicioni qeverisës.

Kriza mes partnerëve të koalicionit qeverisës LSDMS-së dhe BDI-së, u provokua pas dorëzimit të pesë mijë amendamenteve të partisë shqiptare në pushtet bashkë me një mijë amendamentet e VMRO DPMNE-së lidhur me ndryshimet e Kodit Zgjedhor. Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, tha se do të konsultohet rreth shqyrtimit të pozicioneve me kryesinë e partisë dhe partitë më të vogla që janë pjesë e koalicionit dhe do të dalin me vendimin ndaj koalicionit me BDI-në.

"Numri i amendamenteve është një mesazh shumë i palogjikshëm

nga partneri ynë, BDI. Ne kemi folur se përse është e nevojshme një njësi zgjedhore. Nuk guxojmë të mos e dëgjojmë edhe zërin e partive më të vogla. Këto amendamente janë sinjal se duan ta bllokojnë procesin. Kështu bllokohet demokracia në procesin e vendimmarrjes", tha Zaevi.

Por, zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, është arsyetuar se amendamentet janë në funksion të mbrojtjes së fuqizimit të elektoratit shqiptar.

Naser Ziberi, njohës i çështjeve politike, ish-deputet, për "Radion Evropa e Lirë" thotë se është bërë praktikë që gjithmonë para zgjedhjeve qofshin ato parlamentare apo lokale, partnerët e koalicionit qeverisës ata shqiptarë dhe maqedonas të shprehinkundërshtime rreth çështjeve të caktuara me qëllim që të përmirësojnë imazhin para votuesve.

"Në esencë nuk ka ndonjë dallim konceptual serioz që do të mund të çojë deri në prishjen eventuale të koalicionit bashkëqeverisës. Ndoshta kjo qeveri po i numëron ditët, përkatësisht së shpejti do të



rikonfirmohet qeveria e re teknike e transicionit me kryeministër të ri teknik dhe ministra të tjerë dhe nuk ka kohë për të bërë ndonjë ndryshim eventual për një bashkërenditje të strukturës qeverisëse", tha ai.

"Pra, me një fjalë konstatoj se kjo është vetëm një përpjekje për të rritur mbështetjen në elektorat në prag të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare", vlerëson Naser Ziberi.

Përderisa, politikologu maqedonas, Nikolla Dujovski, shprehet më i përmbytur rreth asaj se, sa është reale kriza mes partnerëve të koalicionit qeverisës.

"Nëse bëhet fjalë për ndonjë skenar politik ose jo unë nuk mund të them do të isha i përmbytur në këtë drejtim, sepse kjo situatë mund të vlerësohet në mënyra të

ndryshme. Parlamenti do të shpërbëhet pas 50 ditësh dhe në asnjë mënyrë nuk ka hapësirë për ndryshim të partnerëve të koalicionit gjatë kësaj periudhe përderisa pas zgjedhjeve mbetet të shihet se si do të vazhdojnë raportet mes BDI-së dhe LSDM-së", thotë Dujovski.

Nga ana tjetër, Naser Ziberi thotë se tensionet mes partnerëve të koalicionit qeverisës do të jenë edhe më të theksuara deri në mbajtjen e zgjedhjeve, por shton se elektorati tanimë e ka të qartë fushëveprimin e të dy partive andaj vështirë se do të mund të kenë ndonjë ndikim real.

"Mendoj se janë tentativa të kota për arsye se kjo dramë e krijuar lexohet që nga larg. Dy partitë që qeverisin gjatë gjithë mandatit pa probleme dhe vetëm në prag të

zgjedhjeve nxjerrin diferenca në qëndrime, është një lojë e tejdokshme dhe nuk mendoj se do të kenë ndikim dhe efekt në elektorat", thotë Ziberi, duke kujtuar se partnerët e koalicionit edhe më herët kanë pasur dallime rreth çështjes së ligjit që rregullon përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, pas rekomandimeve të Komisionit të Venedikut, emërimit të kryeprokurorit publik, si dhe çështje të tjera.

Nga ana tjetër, partitë politike shqiptare në opozitë, përplasjet mes Lidhjes Socialdemokrate të kryeministrit Zoran Zaev dhe Bashkimit Demokratik për Integrim i shohin si tentim që BDI-ja të krijojë pozicione më të relaksuara me VMRO DPMNE-në, nëse partia maqedonase në opozitë arrin të shënojë fitore.

Institucionet e BE-së, të shqetësuara lidhur me projektligjin për shtypin në Shqipëri

BRUKSEL, 17 DHJETOR - Komisionarja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatović, ka shprehur shqetësim lidhur me projektligjin për shtypin në Shqipëri, për të cilin kritikët thonë se minon lirinë e shprehjes dhe të mediave.

Parlamenti i Shqipërisë pritet të shqyrtojë sot (e mërkurë) pakon ligjore "anti-shpifje", përmes së cilës, autoritetet shqiptare, synojnë t'i obligojnë mediet online të regjistrohen në organet qeveritare. Masa ligjore parasheh gjoba të larta për mediet e paregjistruara. Mijatović tha se pakoja e propozuar ka nevojë për përmirësim urgjent, pasi disa dispozita nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të lirisë së shtypit. Mijatović u kërkoi ligjvënësve shqiptarë të ndryshojnë legjislacionin në përputhje me



rregullat evropiane.

Konkretisht, ajo shprehu shqetësim lidhur me kompetencat që ky ligj u jep dy organeve

rregullatore, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive,

për të bllokuar faqet e internetit të medieve, pa një urdhër gjyqate.

"Është me rëndësi të madhe që interneti të mbetet një forum i

hapur dhe publik dhe të mbizotërojë vetë-rregullimi nga mediet, përfshirë ato online", tha ajo.

Edhe Komisioni Evropian (KE) ka shprehur shqetësim lidhur me projektligjin për shtypin në Shqipëri, pavarësisht ndryshimeve që i janë bërë gjatë ditëve të fundit, transmeton "Zëri i Amerikës".

Një zëdhënës i Komisionit Evropian, ka thënë se varianti i fundit nuk merr parasysh një sërë rekomandimesh që i janë bërë nga faktorë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Masa ligjore është kritikuar nga shoqatat e gazetarëve shqiptarë si dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Grupet e gazetarëve kanë planifikuar një protestë sot (e mërkurë), në kohën kur Parlamenti debaton për projektligjin.

Demokracia në Veprim (DnV) publikon raportin e vëzhgimit të zgjedhjeve

Reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të qeverisjes së ardhshme



Demokracia në Veprim (DnV) ka mbajtur të martën tryezën "Procesi zgjedhor 2019: Mësimet e mësuara dhe rruga përpara", në të cilën është publikuar raporti përfundimtar i vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit dhe raporti i monitorimit të mediave gjatë fushatës elektorale të këtyre zgjedhjeve. Në këtë tryezë janë diskutuar të gjeturat kryesore dhe rekomandimet që dalin nga këto raporte, si dhe është theksuar domosdoshmëria e përmbylljes së procesit të reformës zgjedhore, si parakusht për tejkalimin e sfidave të evidentuara në këto zgjedhje

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Koalicioni i OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve Demokracia në Veprim (DnV) ka organizuar të martën tryezë diskutimi në të cilën është publikuar "Raporti i vëzhgimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës", të cilat janë mbajtur më 6 tetor të këtij viti. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin ligjvënës nga legjislatura e kaluar, zyrtarë të institucioneve përgjegjëse për organizimin dhe

administrimin e zgjedhjeve, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, subjektet politike si dhe kori diplomatik. Me këtë rast, ambasadori gjerman Christian Heldt ka përgëzuar punën e DnV-së për vëzhgimin e zgjedhjeve të 6 tetorit. "Dua ta përgëzoj punën shumë profesionale të Demokracisë në Veprim për vëzhgimin e zgjedhjeve kombëtare 2019. Është e shkëlqyeshme të shohësh një koalicion të gjerë të OJQ-ve nga të gjitha komunitetet teksa bëjnë një punë të shkëlqyeshme dhe bëjnë bashkë ekspertizën e

tyre. Jemi krenarë që Zyra e Jashtme Gjermane ishte mbështetësjë kryesore e KDI-së në emër të Demokracisë në Veprim, në këtë proces zgjedhor".

Të gjeturat kryesore të raportit të monitorimit të zgjedhjeve u prezantuan nga Eugen Cakolli nga DnV-ja, i cili vlerësoi që procesi zgjedhor është zhvilluar në frymë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të organizimit të zgjedhjeve, përveç në komunat me shumicë serbe, ku qytetarëve u është bërë presion të votojnë një subjekt të caktuar politik. "Sidoqoftë, pavarësisht vlerësimit pozitiv për zgjedhjet, 88.2 për qind e vendotimeve i janë nënshtruar procesit të rinumërimit, kryesisht lidhur me gabimin teknik të Sekretariatit të KQZ-së në formularët e përputhjes së rezultateve, duke shkaktuar vonesën më të gjatë të certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve që nga viti 2010", ka thënë Cakolli. Ai, gjithashtu, ka theksuar se pranimi i mbi 6 000 pakove me fletëvotime të supozuara përmes votimit me postë jashtë vendit pas afatit ligjor dhe anulimi i mbi 3 000 votave të ardhura nga Serbia jashtë procedurës së para-

parë ligjore, janë dy nga çështjet më të ndjeshme dhe komplekse që kanë karakterizuar këto zgjedhje. "Monitorimi i shpenzimeve të subjekteve politike gjatë fushatës tregon që në 747 aktivitete, sipas përlogaritjeve, janë shpenzuar rreth 3.6 milionë euro. Tavani i shpenzimeve për fushatën zgjedhore, siç parashihet me ligj, është tejkaluar vetëm nga LDK-ja", ka thënë ai. Sa iu përket rekomandimeve që dalin nga ky raport, fillimisht u theksua se reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të qeverisjes së ardhshme dhe e njëjta duhet t'i përfshijë sfidat e evidentuara gjatë këtyre zgjedhjeve. Ndërsa rekomandimet e tjera u tha që synojnë përmirësimin e procesit zgjedhor, duke përfshirë çështjen e afateve të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme, numërimin, përmirësimin e kapaciteteve të trupave menaxhuese të zgjedhjeve, votimin jashtë vendit, informimin dhe edukimin e votuesve, fushatën zgjedhore, financimin e subjekteve politike gjatë fushatës, listën e votuesve, përfaqësimin gjinor në lista të kandidatëve, drejtësinë zgjedhore dhe harmonizimin e kornizës ligjore.

Paneli i diskutimit në këtë tryezë

u përbë nga drejtori për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim, Yll Buleshkaj, si dhe ish-kryetari i Komisionit Ad-hoc për Forcimin dhe Përmirësimin e Procesit Zgjedhor, Avdullah Hoti. Duke diskutuar për rëndësinë e reformës zgjedhore, si parakusht për tejkalimin e sfidave të dala nga këto zgjedhje, pjesëmarrësit u pajtuan që të gjithë aktorët relevantë duhet ta japin kontributin e tyre për përmbylljen e procesit të kamotshëm të reformës zgjedhore, i cili duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të skenës politike kosovare.

Dorëheqja e parevokueshme e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, më 19 korrik të këtij viti, i hapi rrugë shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës dhe organizimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Deputetët votuan shpërndarjen e Kuvendit më 22 gusht, ndërsa presidenti i Kosovës, pasi dekretoi shpërndarjen e Kuvendit, shpalli zgjedhjet për datën 6 tetor. Këto ishin zgjedhjet e katërta nacionale që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Asnjë qeveri nuk ka arritur ta përfundojë mandatin e plotë katërvjeçar.

Hoti shpreson se deri më 26 dhjetor të arrijnë marrëveshje me Vetëvendosjen

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se kjo parti është duke insistuar në një marrëveshje të balancuar qeverisëse me Lëvizjen Vetëvendosje, pjesë e së cilës duhet të jetë edhe posti i

presidentit. Hoti ka thënë se i takon Vetëvendosjes që ta thërrasë takimin e radhës. Ai shpreson se deri më 26 dhjetor të arrihet marrëveshja në ditën kur edhe është thirrur seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës. "Ne jemi duke insistuar që të arrijmë një

marrëveshje për të qeverisur sa më parë. Një marrëveshje që balancon përgjegjësitë. Ne kemi zhvilluar të gjitha konsultimet e brendshme. Nuk jam në dijeni që është caktuar ndonjë takim. Shpresoj se deri atëherë të arrijmë marrëveshje", ka thënë Hoti.



Flet për "Epokën e re", Pal Lekaj

Interesat e ngushta të LV-së dhe të LDK

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), aktualisht ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka thënë se pazaret personale të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë duke e penguar arritjen e marrëveshjes për krijimin e institucioneve të reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se këto interesa të këtyre dy subjekteve politike mund ta çojnë vendin në zgjedhje të reja. Sipas Lekajt, një gjë e tillë do të ishte dëshpëruese për qytetarët. Ai ka ftuar LV-në dhe LDK-në ta shikojnë interesin kombëtar dhe të heqin dorë nga interesat e ngushta partiake dhe t'i formojnë institucionet e reja



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Pal Lekaj, ka deklaruar se zvarritja e negociatave për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) është duke ndodhur për shkak të interesave të ngushta personale. Ai i ka ftuar këto dy subjekte politike që sa më shpejt të arrijnë marrëveshje për krijimin e institucioneve. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Lekaj ka thënë se krijimi i institucioneve nuk duhet të mbahet peng i interesave partiake. "Është e pakuptimtë që dy subjektet politike që kanë fituar zgjedhjet, pra subjekti i parë dhe i dytë, të mos kenë marrëveshje ende për t'i krijuar institucionet. Ne po presim që në ditët e ardhshme ata të pajtohen dhe

t'i krijojnë institucionet, mirëpo po e shoh se midis dy subjekteve politike po dominon pazari i individëve të caktuar se si mund të rreshtohen në pozita të larta shtetërore dhe jo që të angazhohen për të punuar në të mirën e qytetarëve të vendit", ka thënë Lekaj. Ai ka theksuar se qëndrimet e këtyre dy subjekteve po tregojnë se nuk janë të interesuar t'i krijojnë institucionet. "Kjo po ndodh për shkak të interesave të ngushta personale dhe partiake. Po e shihni tani se premtimi i tyre, se do të ketë marrëveshje një ditë pas certifikimit të rezultateve, nuk po ndodh. Kjo i bie se të dy subjektet politike nuk janë fort të interesuara që t'i krijojnë institucionet", është shprehur Lekaj. Ai e ka bërë të qartë se AAK-ja në këtë mandat do të mbetet në opozitë. Sipas Lekajt, kjo parti nuk do të përfshihet në negociatën për krijimin e koalicionit qeverisës. "Qëndrimi

Dënohet dëmtimi i varrezave ortodokse në Lipjan

LIPJAN, 17 DHJETOR - Ministrija në detyrë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Adriana Hoxhiq, e ka dënuar dëmtimin e varrezave ortodokse në Komunën e Lipjanit. Më 17 dhjetor Policia e Kosovës ka raportuar se në Lipjan disa varreza janë dëmtuar nga persona

të panjohur dhe se një hetim intensiv po zhvillohet lidhur me këtë incident. Policia nuk ka dhënë më shumë detaje. "Dëmtimi i varrezave në Komunën e Lipjanit meriton dënimin më të fuqishëm. Unë besoj se ky është një veprim për të cilin ne si shoqëri duhet të

ndihemi të turpëruar, pavarësisht prejardhjes sonë etnike dhe fetare", ka thënë Hoxhiq përmes një deklaratë. Ajo u bëri thirrje autoriteteve lokale në Lipjan, që në bashkëpunim me agjencitë e zbatimit të ligjit, të krijojnë të gjitha mekanizmat e nevojshëm për gjetjen dhe

ndëshkimin e autorëve. Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, ka thënë se "dëmtimi i gurëve të varrezave serbe në Lipjan edhe një herë na ballafaqon me faktin e trishtuar se procesi i pajtimit ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë

pati shumë pak rezultate". Në Komunën e Lipjanit edhe në të kaluarën kanë ndodhur incidente të tilla. Më 14 korrik Policia e Kosovës njoftoi se është duke kryer hetime pas njoftimeve se "janë dëmtuar disa gurë të varrezave ortodokse serbe" në Komunën e Lipjanit.

K-së mund ta çojnë vendin në zgjedhje



ynë është i qartë për këtë çështje. Ne do të jemi në opozitë sepse kështu ka vendosur sovranin më 6 tetor. Mirëpo ne kemi treguar gatishmëri që kur është interesi i vendit për çështje madhore do të përkrahim çdo proces që shkon në favor të forcimit të shtetit. Pra, ne do të jemi opozitë. Tani është radha e tyre ta menaxhojnë më mirë situatën dhe mos ta dërgojnë vendin prapë në zgjedhje", është shprehur Lekaj.

Megjithatë, ai ka treguar se LV-ja dhe LDK-ja mund ta çojnë vendin sërish në zgjedhje. Ai ka thënë se një gjë e tillë do të ishte dëshpëruese për qytetarët. "Besoni se, siç po shihen gjërat, nuk ka tjetër alternativë përveçse vendi të shkojë në zgjedhje të reja, ani pse një gjë e tillë do të ishte një dëshpërim i madh për qytetarët", është shprehur Lekaj.

"Epoka e re": Z. Lekaj, si po i shihni përpjekjet e LV-së dhe të LDK-së për formimin e qeverisë së re?

Lekaj: Kjo është sikur dikush që kërkon punë, ndërsa në anën tjetër e lut Zotin të mos gjejë punë. Është e pakuptimtë që të dyja subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet, pra subjekti i parë dhe i dytë, të mos kenë marrëveshje ende për t'i krijuar institucionet. Ne po presim që në ditët e ardhshme ata të pajtohen dhe t'i krijojnë institucionet. Mirëpo po e shoh se midis dy subjekteve politike po dominon pazari i individëve të caktuar se si mund të rreshtohen në pozita të larta shtetërore e jo të angazhohen që të punojnë për të mirën e qytetarëve të vendit.

"Epoka e re": Pse po zvarritet kaq shumë marrëveshja mes tyre?

Lekaj: Për shkak të interesave të ngushta personale dhe partiake. Po e shihni tani se premtimi i tyre, se do të ketë marrëveshje një ditë pas certifikimit të rezultateve, nuk

po ndodh. Kjo i bie se të dyja subjektet politike nuk janë fort të interesuara që t'i krijojnë institucionet.

"Epoka e re": Këto dy subjekte politike sa kanë qenë në opozitë e kanë kritikuar qeverinë në detyrë dhe vazhdimisht kanë kërkuar zgjedhje të reja. Cili është qëndrimi juaj tash kur këto nuk po mund të merren vesh për poste të caktuara?

Lekaj: Kjo tregon se kritikën e tyre atëherë kanë qenë mungesë e alternativave. Tani kur i kanë numrat për ta bërë qeverinë këta po ngecin. Në këtë mënyrë prej ditëve të para po krijojnë mosseriozitet dhe mosgatishmëri që të bëjnë kompromise. Kompromiset çdoherë janë të mirëseardhura në tavolinë, sidomos kur dominon interesi i qytetarëve të vendit.

"Epoka e re": Nga këto që keni parë deri më tani, sa besoni se LV-ja dhe LDK-ja do të mund të arrijnë një marrëveshje për bashkëqeverisje?

Lekaj: Nuk dua të ndërhyj në punët e atyre dy subjekteve politike por, siç po shihet, janë larg arritjes së një marrëveshje për bashkëqeverisje. Mirëpo ne si opozitë e ardhshme i ftojmë që sa më parë t'i krijojnë institucionet e reja dhe t'i lënë anash interesat individuale dhe klanore.

"Epoka e re": Pengesa kryesore për marrëveshjen në mes të këtyre dy subjekteve politike po shihet se është posti i presidentit. A do të duhej të përfshihej në marrëveshjen për formimin e institucioneve edhe posti i presidentit të ardhshëm?

Lekaj: Natyrisht se presidenti do të duhej të ishte një kandidat konsensual, sepse presidenti përfaqëson unitetin e popullit. Mirëpo, siç po shihet, këta kanë interesa të caktuara politike dhe e kanë politizuar këtë çështje. Ajo që mund të them është se edhe po të arrijnë një marrëveshje për presidentin

e ardhshëm, këto dy parti nuk i kanë dy të tretat e deputetëve në Kuvend dhe nuk e di pse e kanë shtruar tash këtë çështje. Siç dihet, për t'u zgjedhur presidenti i Kosovës në sallë duhet të jenë 80 deputetë, kurse këta nuk i kanë 80 deputetë.

"Epoka e re": Sa besoni se do të funksiononte një koalicion në mes të këtyre dy pritave?

Lekaj: Në bazë të asaj që ne i njohim këto dy subjekte politike, mendoj se qeveria e tyre do të jetë shumë jetëshkurtër dhe nuk do të funksiononte. Këto dy subjekte politike nuk kanë pasur një bashkëpunim parimor në të kaluarën. Bashkëpunimi i tyre po ndodh vetëm për interesa të pushtetit dhe jo për gjëra të tjera. Të gjithë e dimë se cili ka qenë qëndrimi i LV-së ndaj LDK-së. Po ashtu, dihen qëndrimet e LDK-së ndaj LV-së. Pra, natyrisht se brenda natës nuk mund t'i kalojnë përplasjet dhe kundërshtimet që i kanë pasur këto parti mes vete në të kaluarën.

"Epoka e re": Në rast se nuk do të kemi një marrëveshje mes tyre, AAK-ja është e gatshme të bëhet pjesë e qeverisë së re?

Lekaj: Qëndrimi ynë është i qartë për këtë çështje. Ne do të jemi në opozitë sepse kështu ka vendosur sovranin më 6 tetor. Mirëpo ne kemi treguar gatishmëri që kur është interesi i vendit për çështje madhore do të përkrahim çdo proces që shkon në favor të forcimit të shtetit. Pra, ne do të jemi opozitë. Tani është radha e tyre që ta menaxhojnë më mirë situatën dhe mos ta dërgojnë vendin prapë në zgjedhje.

"Epoka e re": Çka nëse nuk pajtohen LV-ja dhe LDK-ja për bashkëqeverisje. Cila duhet të jetë alternativa?

Lekaj: Besoni se, siç po shihen gjërat, nuk ka tjetër alternativë përveç se vendi të shkojë në zgjedhje të reja, ani pse një gjë e tillë do të ishte një dëshpërim i madh për qytetarët.

Kurti dhe ambasadori italian flasin për sfidat e koalicionit qeverisës LV-LDK

PRISHINË, 17 DHJETOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të martën në takim lamtumirës ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi, me të cilin kanë biseduar për rëndësinë e avancimit të mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve. Po në këtë takim është

biseduar për përvojat e Italisë për forcimin e saj ligjor e demokratik dhe ndihmën e mbështetjen që mund ta japë ky vend për shtetndërtimin e Kosovës. Më tutje, Kurti e Sardi kanë diskutuar për situatën aktuale në Kosovë, me theks për arritjet dhe sfidat drejt koalicionit qeverisës midis LV-së dhe LDK-së. "Kryetari Kurti e

falënderoi ambasadorin Sardi për bashkëpunimin gjatë këtyre viteve duke i dëshiruar punë të mbarë në angazhimet e tjera të tij. Me ambasadorin e ardhshëm urojmë që të vazhdojë puna dhe takimet e përbashkëta me qëllim të forcimit të marrëdhënieve ndërshtetërore", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.



Ambasadori britanik shpallet mik nderi i Gjimnazit 'Hajdar Dushi' në Gjakovë

GJAKOVË, 17 DHJETOR (ER) - Komuna e Gjakovës është komuna e parë që është vizituar nga ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, ku është pritur në takim nga kryetari Ardian Gjini. Në këtë takim, ambasadori Abbott dhe kryetari Gjini kanë biseduar për mundësitë e zhvillimit të Gjakovës dhe Kosovës. "Jam shumë i lumtur që jam sot në

Gjakovë. Kjo është vizita ime e parë zyrtare në Kosovë, pas Prishtinës. Me kryetarin biseduam për të ardhmen e Gjakovës dhe Kosovës në përgjithësi", u shpreh ambasadori Abbott pas takimit. Ndërsa kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se Britania e Madhe është mbështetëse e madhe e Kosovës. "Është kënaqësi e madhe ta kemi ambasadorin e

Mbretërisë së Bashkuar në Gjakovë. Kemi marrëdhënie shumëvjeçare me Britaninë e Madhe, e cila ka qenë mbështetëse e madhe e Kosovës edhe në kohët më të vështira, por edhe tash", ka deklaruar Gjini. Pas këtij takimi, në një ceremoni solemne, ambasadori Abbott është shpallur mik nderi i Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.



Malisheva shënon rënie të veprave penale



Malishevë, 17 dhjetor (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Malishevës, nën drejtimin e nënkryetarit të kësaj komune, Hajdin Berisha, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë dhe të fundit për vitin 2019, në të cilën është ritheksuar se Malisheva vazhdon të mbetet vend i sigurt në fushën e sigurisë së përgjithshme. Gjatë raportimeve të organeve përgjegjëse për sigurinë në vend është theksuar edhe një herë se në Komunën e Malishevës situata e sigurisë së përgjithshme është stabile.

Sipas komandantit të Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, në këtë vit ka rënie të veprave penale, ndërsa zbulimi i rasteve ka shënuar rritje falë investimeve në fushën e sigurisë, me vendosjen e kamerave të sigurisë, si dhe duke iu falënderuar bashkëpunimit të mirë me qytetarët për zbulimin e rasteve. Gjatë diskutimeve nga anëtarët e KKS-së në Malishevë është rekomanduar që të punohet për hapjen e një nënstacioni policor në Kijevë si dhe të një nënstacioni të zjarrfikësve po në këtë vendbanim.

Korça njofton për fillimin e punimeve për ndërtimin e Çarshisë së Gjilanit

GJILAN, 17 DHJETOR (ER) - Drejtori i Shërbimeve Publike në Gjilan, Naser Korça, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për ndërtimin pjesës së tretë të Çarshisë së Gjilanit - veri, në gjatësi prej 1 183 metrash, kostoja e së cilës është afër 1 milion euro. "Ky është projekti më madhor që po fillon këtë vit në Gjilan dhe shpresojmë se do të përfundojë gjatë verës së vitit të ardhshëm. Do të jetë një shëtitore e bukur nga rruga 'Rexhep Dajkovci' e deri në lagjen 'Dardania',

konkretisht deri te butiku 'Menakon', që do ta lidhë pjesën jugore me pjesën veriore të qytetit, përkatësisht 'Deremahallën', qendrën dhe lagjen 'Dardania'. Me këtë po synojmë përdorimin sa më pak të veturave", ka thënë Korça në një konferencë për medie. Duke folur për punën njëvjeçare të këtij dikasteri, Korça ka përmendur edhe projektet e përfunduara infrastrukturore gjatë këtij viti, siç janë rrugët lidhëse në rrugën e Prishtinës, lagjen

"Fehmi Agani", lagjen "Pajazit Ahmeti", "Hysen Terpeza", rrugët kryesore që çojnë në fshatin Cernicë, lagjen e "Porodinit", lagjen e "Jabuqëve" etj. Ai ka thënë se për vitin e ardhshëm do të përfundojnë projektet infrastrukturore me elementet përcjellëse në Përlepnicë, Livoç i Epërm, Livoç i Ulët, Malishevë e Epërme, rruga e vjetër Zabel-Uglar, rruga Stublinë-Dobërçan, rruga Dobërçan-Pogragjë, sikurse edhe ura shumë e nevojshme në fshatin Dobërçan.



Fillon procesi i legalizimit të objekteve pa leje në Klinë

KLINË, 17 DHJETOR (ER) - Pas përgatitjeve teknike të bëra nga ana e Komunës së Klinës lidhur me ofrimin e shërbimit më të mirë lidhur me procesin e legalizimit të objekteve apo shtëpive, kjo komunë edhe zyrtarisht ka filluar pranimin e aplikimeve për legalizim të shtëpive dhe objekteve të tjera të ndërtuara pa leje.

Me këtë rast kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, ka theksuar se legalizimi i objekteve ka një rëndësi të madhe duke pasur parasysh se është një numër i konsiderueshëm i objekteve të ndërtuara pa leje, të cilëve tashmë po u jepet mundësia ta fillojnë



procesin e legalizimit të tyre. Ligji i legalizimit i trajton të gjitha ndërtimet si në qytetet ashtu edhe në fshatra, andaj Komuna e Klinës fton të gjithë qytetarët që të aplikojnë për legalizime të shtëpive dhe objekteve.

Komuna e Mitrovicës dhe "Down Syndrome Kosova" nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

MITROVICË, 17 DHJETOR (ER) - Drejtori i Arsimit në Komunën e Mitrovicës, Egzon Jashari, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me OJQ "Shoqatën Down Syndrome Kosova", për zbatimin e projektit "Fuqizimi i sistemeve mbështetëse drejt realizimit të të drejtave të personave me sindromën down". Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është furnizimi i shkollave me mjetet didaktike të cilat do ta lehtësojnë procesin mësimor brenda klasës ku mësojnë



fëmijë me nevoja të veçanta, me këtë rast për fëmijët me sindromën down.

Haradinaj: AAK-ja nuk bëhet pjesë e qeverisë Kurti



Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kryeministër në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se partia që drejton nuk do të jetë pjesë e qeverisë Kurti nëse i vjen një ofertë e tillë. Ai ka bërë thirrje që sa më shpejt të formohen institucionet e reja të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), njëherësh kryeministër në detyrë, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije të martën se subjekti politik që drejton nuk do të bëhet pjesë e qeverisë së ardhshme. Këtë deklaratë Haradinaj e dha në një konferencë për media pas mbledhjes së kabinetit qeveritar. "Ne jemi opozitë dhe nuk e shohim vetën në qeverinë Kurti. Pra, do të mbesim në opozitë këtë mandat", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka thënë se do të ishte mirë për vendin që sa më shpejt të formohen institucionet. "Është mirë që

sa më shpejt të krijohen institucionet e vendit. Nuk është mirë të vonohen pakufi. Barra bie mbi fituesin. Këtu nuk e kam për ta shfaqësuar dikë tjetër, por kush i ka fituar zgjedhjet, në këtë rast Vetëvendosje, barra i bie të komunikojë me palë për t'i krijuar institucionet", është shprehur Haradinaj. Ai ka thënë se fituesit i takon të bëjë kompromise për t'i krijuar institucionet e Kosovës të dala nga zgjedhjet e 6 tetorit.

Haradinaj ka thënë se nuk i takon atij të merret me çështjet që janë duke biseduar LV-ja dhe LDK-ja, duke përfshirë pozitën e presidentit. Në këtë kontekst, ai ka thënë se për çështjen e presidentit nuk ka folur askush me të.

Haradinaj ka thënë se qeveria e re, për fat të keq, nuk do t'i përm-bushë pritjet e qytetarëve. Sipas tij, qeveria Kurti do të jetë zhgënjim për qytetarët e Kosovës.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka folur për pezullimin e Ligjit për paga nga Gjykata Kushtetuese. Votimin e këtij ligji e quajti meritë të qeverisë së tij pasi, sipas tij, me këtë ligj është vendosur rregull ligjor i pagave. Ndonëse është pezulluar nga Gjykata Kushtetuese ky ligj, Haradinaj ka theksuar se e kanë humbur betejën ata që e kundërshtojnë këtë çështje. "Kjo për mua është meritë që i kemi dhënë Kosovës këto ligje dhe janë ligje që vendosin rregull ligjor të pagave në shërbim publik dhe

Ndahen mbi dy milionë euro për Policinë e Kosovës

Në mbledhjen e së martës të Qeverisë së Republikës së Kosovës unanimisht miratuar Platformën Vjetore të Politikave të Intelgjencës dhe Sigurisë si parakusht për funksionimin e këtij sektorit të rëndësishëm për vendin. Po ashtu, u miratua projektregullorja për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet e tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, në përputhje me strukturën e gradave të organizimit të brendshëm, veprim ky që përkon me zotimet për forcim dhe avancim të FSK-së. Qeveria vendosi, gjithashtu, që nga kursimet dhe ndarjet buxhetore të këtij viti ta ndajë shumën prej 2 milion e 52 mijë

eurosh për kompensimin e shtesave në pagë për punën jashtë orarit për Policinë e Kosovës gjatë vitit 2018.

Është miratuar edhe rregullorja për shtesën e rrezikshmërisë në punë për Policinë e Kosovës që do të hyjë në zbatim bashkë me Ligjin e Pagave.

Me vendim qeveritar, të martën është bërë edhe ndarja e mjeteve financiare për shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së. Po ashtu, u aprovua në parim nisma për nënshkrimin e marrëveshjes financiare trepalëshe me Bashkimin Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2018, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar, IPA II në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

administratë, e ata që po mundohen t'i zbehin këto, e kanë të

humbur këtë betejë", ka thënë Haradinaj.

Punimet për ndërtimin e Spitalit Pediatrik-Kirurgjik janë në fazën finale

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), bashkë me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, kanë vizituar hapësirat në të cilat janë duke u kryer punimet finale për ndërtimin e Spitalit Kirurgjik Pediatrik. Pas vizitës në këto hapësira, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka theksuar se ky objekt do të jetë modern, me infrastrukturë përcjellëse.

Drejtori Sejdiu ka njoftuar se ky objekt do të bëjë që të rritet kualiteti i shërbimeve, fillimisht atyre të kirurgjisë pediatrike, pastaj neonatologjisë dhe emergjencës pediatrike, kurse do t'i ketë edhe pajisjet më moderne, që janë fjala e fundit e teknologjisë.

Ministri Ismaili, pas vizitës, ka thënë se në bazë të ritmit të punimeve, ato pritet të përfundojnë në gjysmën e vitit tjetër. Duke folur për kapacitetet që ka ky institucion, ai ka bërë me dije se objekti ka rreth 10 mijë metra katrorë, kapacitet për 100 shtretër dhe pajisje bashkëkohore për

shërbime profesionale ndaj fëmijëve.

Sipas tij, për zbatimin e këtij projekti kishte shumë probleme dhe kohë, edhe pse donatori dhuroi paratë, kurse tashmë ndërtimi i objektit është në fazën finale.

Projektmenaxheri i projektit nga kompania "Mabetex" ka potencuar se punimet tashmë janë në fazën finale dhe po punohet për ndërtimin e servis blloqeve që do të shërbejnë për funksionimin e këtij spitali, kurse punimet janë kryer me kualitet shumë të lartë. Projekti për ndërtimin e Spitalit



Pediatrik-Kirurgjik është financuar nga Emiratet e Bashkuara

Arabe dhe ka kushtuar 20 milionë euro.

Se kush do të jetë president i Kosovës vendos opozita e jo pozita!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Marrëveshja apo çkapja e shtetit nëpërmjet kapjes së pushtetit. Gjatë tërë kohës sa ishte në opozitë, LV-ja thajse pjesën dërmuese të veprimtimit opozitar e ndërtonte mbi themelet e luftës për çkapje të shtetit dhe institucioneve nga kapësit e që ishin, sipas saj, ata që e drejtonin shtetin. Edhe një pjesë e LDK-së, e që ishte opozitë e brendshme e vet LDK-së, modelin e kapjes së shtetit e përdornte jo vetëm për çkapje të shtetit, por edhe për çkapje të LDK-së, me të vetmin qëllim që edhe ata të kapnin diçka, ndonjë pozitë, qoftë brenda LDK-së, si hap i parë e pastaj edhe në nivele më të larta. Kapja dhe çkapja, si folje e fjalorit seksologjik, përnjëherë u bë kryefjala dhe kallëzuesi i fjalorit politik në Kosovë! LV-ja dhe një pjesë e LDK-së u bënë qendra e promovimit të kësaj retorike e që hasi në përkrahje edhe të rrethit më të gjerë për faktin se, si kapje dhe çkapje ishte atraktive (sikur çdo gjë që sillt rreth ushkurit) për veshin e dëgjuesit. LV-ja nuk kishte përvojë në kapje (të pushtetit), por u dëshmuoi si kapëse shumë e zonja kur e kapi dhe e dhunoi Prishtinën përmes një hamshori, impotent në mirëveprim, por shumë potent në keqveprim, si puna e Shpendkeqes që e shndërroi kryeqytetin në një Hiroshimë të shkatërrimit dhe xhungël të ndërtimit, duke pasuruar skajshmërisht oligarkët ekzistues si dhe oligarkët e rinj e që vinin nga partia që i takonte e që u konvertua në një parti tjetër e cila kapjen e shndërroi në një art aplikativ. Mytazeri në Prizren nuk po ka mundësi as të kapë e lëre më të çkapë sepse po ia nxjerrin njëqindmijë probleme, kurse Qendroni në Kamenicë tërë kapjen e ka me legjendarin Rrahman Jasharin nga i cili assesi të çkapet! Në një vend ku kapë Rraha, për dhe me asnjë çmim nuk këndon as Mihrije Braha!

Lidhja Demokratike e Kosovës ka traditë shembullore dhe çerekshkullore në profesionin e kapjes së shtetit, që nga koha para Krishtit (para shpalljes së pavarësisë së Kosovës) e deri më sot. Përfashtuar kohën kur Ramushi ishte kryeministër i Kosovës (afërsisht dy vjet), nga viti 2005, ndonjëse asnjëherë nuk doli fituese e zgjedhjeve, gjithmonë ishte pronare e tortës apo ndarjes së kulaçit, prandaj duket jo fort serioze që me aq vendosmëri "angazhohet" për çkapje të shtetit përmes rimarrjes së pushtetit! Pikërisht ata që kanë qenë më të zëshmit në "çkapjen e shtetit", pasi kapën fort shumë poste për vete dhe familjarët e tyre, si brenda Kosovës ashtu edhe jashtë saj (sidomos në planin diplomatik),

përsëri i janë kthyer kësaj retorike pornografike-politike e që po e keqpërdorin si karrem për qytetarin - votuesin të cilit i ka ardhur shpirti deri në fyt, duke u premtuar parajsë ndonjëse, deri më tani, i kanë zbatuar rregullat e ferrit! Ju djallit edhe mund t'ia shkurtoni brirët, por jo edhe përmbajtjen e as statusin që e ka.

Pse nuk po bëhet koalicioni: Më herët pata shkruar se dashuria midis LV-së dhe LDK-së është një tregim dhe një përjetim i pashkruar dhe papërtjetuar deri më tani që ka kaluar prej pasioneve më të fuqishme, deri te shkaktimi i vuajtjeve më të mëdha; si dashuri sado-mazokiste e që më mirë dhe më bindshëm nuk do ta shkruante as Markiz de Sad apo babai i sadizmit! Tundimi apo tërheqja emocionale ka qenë e një intensiteti shumë të lartë, sidomos gjatë fushatave zgjedhore e cila pastaj ka rënë deri në akuza për tradhti dashurore, politike dhe kombëtare pikërisht në kohën kur është dashur të bëjnë koalicion. Kështu ndodhi edhe në zgjedhjet e fundit ku të gjithë prisnin të nënshkruhet koalicioni parazgjedhor, përpjekje që dështonte me premtime të forta se, menjëherë pas certifikimit të rezulttatit të zgjedhjeve, koalicioni i "shpresës" dhe i "çkapjes" do të nënshkruhej menjëherë. Për interes të shtetit e sidomos të pushtetit as që diskutohej për poste përveç të kryeministrit për të cilin as që guxohej të diskutohej. Ishin edhe do zotime të fuqishme të Agim Tartufit (peçurka më e kushtueshme në botë) se, me asnjë çmim nuk e japin Ministrinë e Hurit dhe të Konopit dhe të Kadilerëve edhe nëse duhet të shkohet në zgjedhje të reja. Agimi që u çkapë, pas shumë përpjekjeve nga dhunuesi dhe keqpërdoruesi kryesor i diplomacisë kosovare, Gjet Macolli e që u kap fort me Binin, po tregon qartazi se për të politika është ekuacioni i pazgjidshëm qoftë edhe sipas tabelës së shumëzimit nga një (1) deri në pesë (5). Postin e kryeministrit nuk e kundërshtuan për faktin se LV-ja doli e para në zgjedhje ndonjëse me një rezultat shumë të ngushtë. Kjo nuk ka aspak rëndësi sepse në shumë raste kur dy ekipe e ndajnë vendin e parë, me pikë të njëjta, dallimi vetëm prej një goli e përcakton fituesin. LDK-ja ka bërë llogari si i ka pëlqyer e që do ta bënte çdonjëri: LV-ja do e ketë kryeministrin dhe pesë (ministri) kurse, sipas një quatomatizmi, LDK-së i takon ajo që mbetet; kryetari i Kuvendit, presidenti dhe fillimisht kërkonte shtatë (7) ministri për t'u treguar më e "matur dhe realiste" dhe duke rënë në vetëm pesë (5) ministri. Edhe unë pata menduar dhe mendoj se LDK-ja do t'i ketë ato që i ka kërkuar, jo pse i meriton por se e ka një mundësi të madhe shantazhimi përmes negociatave të "mirëbesimit". Albin Kurti është negociator i fortë me ligën e dytë të LDK-së dhe karrieristët në ardhje të kësaj partie që e duan fuqizimin

përmes shkarkimit apo marginalizimit të meritokracisë së LDK-së, me një angazhim thuaja 30-vjeçare brenda LDK-së! Mirëpo, Albini përkundër përgatitjes fizike nuk e ka të lehtë mos ta them se e ka të pamundur ta mposhtë në bisedime Isa Mustafën, të hirit dhe të konopit. Isa Mustafa, arsyeshmërinë e ka si dukje kurse këmbëngulësinë e ka si përmbajtje, Albin Kurti, duke i eliminuar të gjithë të tjerët e ka fuqizuar shumë pozitën negociuese të Isa Mustafës dhe, në fund edhe do të pajtohet që LDK-ja ta ketë presidentin. Në LDK aktualisht, kapo dei kapi (kreu i krerëve) është Isa Mustafa kurse "engjëj" mbrojtës i ka Agim Velium, Gazin e Muhaxherëve, panker Lutën dhe gradën e vjetër kurse Vjosa Osmani, Dritoni dhe Lumi i Xhikës e kanë rolin e zhurmuesve, pa fuqi reale vendimarrëse! Në lëshimin e madh me ski drejt karrikeres së kryeministrit, Albin Kurti lehtësisht i kalon të gjithë të LDK-së, pavarësisht masës trupore për të marrë në thua pashmangshëm në Isa Mustafën, me probleme shëndetësore fizike por me një tru që po i punon si ora serkisul! Posti i presidentit është investimi i fundit madhor politik i Isa Mustafës, është ruleti që, ose të siguron fitore ose të shndërron në përmendore prandaj Isa nuk ka rrugë tjetër përveç Golgotës dhe Kuroren me Gjembë. Nëse Jezusi apo Isusi e ka mbajtur këtë kurorë gjatë kalimit në Via Dolorosa edhe Isai (Mustafa) mund ta mbajë lehtësisht sepse rrugën e ka shumë të shkurtër; disa dhjetra metra deri te posti i presidentit! Albini është imponues dhe bindës; Agim Bahtirin e ka bindur se është Hasan Prishtina prandaj po ky Agim ka kërkuar që para Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, me emrin e Hasan Prishtinës, të ndërrohet busti dhe të bazamnetin ku sot është Hasan Prishtina, i vjetër dhe i vrarë, të vendoset busti i Agim Bahtirit, i xhelosur dhe i gjallë! Këto gëshënja nuk i ha Isa Mustafa sepse e ka të qartë se pa votën e LDK-së dhe Patriarkut të saj, Albini nuk bëhet dot kryeministër. Kërcënimet me zgjedhje të reja është aq serioz sa kërcënimi im se me armë nukleare do ta bombardojë Somalinë për shkak të pirazterisë dhe rrezikimit të rendit dhe sigurisë globale. Faktori ndërkombëtar 100 për qind është për koalicionin LV-LDK dhe kanë filluar të bëhen nervozë për vonesat e paarsyeshme. Presidenti konsensual është kartë e djegur në një luftë gladiatorësh që po e bëjnë LV-ja dhe LDK-ja për çdo post. Ish-ambasadori i Holandës me mbiemrin e pompës Bosch, prej baustelle ka propozuar tre emra; Fatmir Sejdiu, Veton Surroi dhe Vjosa Dobrunën. Disa portale kanë përfolur emrat e Rexhep Qosjes dhe Murat Jasharit. Ta bëjë një sqarim të vogël për një të vërtetë të madhe; nëse Isa Mustafa bëhet president ka mundësi që ambasadorin Bosch ta shpall person non grata me vet faktin se ka pasur guxim ta propozojë Sejdiun për president. Po të pyetej vetëm

Albin Kurti, Veton Surroi 100 për qind do të bëhej president, me LDK-në Vetoni 100 për qind nuk bëhet president. Vjosa Dobruna ka emër dhe mbiemër të shëndetshëm kombëtar por kjo nuk mjafton që ajo të bëhet presidente. Madje, në rrethanat e sotit në Kosovë kjo merret si rrethanë penguese dhe rënduese. Shembullin më të mirë për këtë e keni rastin e Bacës së Madhe, Adem Demaçi i cili sot kujtohet më pak dhe më rrallë se faroni Tutankamon që ka jetuar mijëra vite më parë. LDK-ja, më parë do të pajtohej që president i Kosovës të bëhej Ivica Daçiçi se Rexhep Qosja kurse Murat Jasharin duan ta mashtrojnë sikur dikur që i premtuan postin e Avokatit të Popullit nga avokatët e djallit! Ndërkombëtarët nuk lejojnë zgjedhje të reja ndonjëse e kanë një arsyeshmëri politike që të mbahen zgjedhjet e reja në Kosovë në kohën kur ato do të mbahen në Serbi dhe Maqedoni të Veriut.

Përbërja e Qeverisë sipas parashikuesve: Vangeliya Pandeva e lindur në vitin 1911 në Maqedoninë e Veriut e cila vdiq në vitin 1996, e njohur si Nostradmusi i Ballkanit, ndonjëse e verbër krejtësisht ka para dhe parashikuar më mirë dhe më se Milaim Zeka, me dy drita syri në ballë i cili, fatmirësisht është shëndosh e mirë. Milaimi ka projektuar Qeverinë Kurti duke i ndarë edhe postet ministore ku ministër për Punë të Brendshme e bëri Nehat Idrizin i cili, mund të bëhet edhe Papë i Vatikanit por nuk e ka ndërtimin dhe përmbajtjen e një ministri për Punë të Brendshme. Edhe Albulena Haxhiu e bëri ministër të Drejtësisë. Dhe kështu me radhë. Së pari nëse LV-ja pranon vetëm Ministrinë e Drejtësisë, nuk do të bënte asgjë. Më e rëndësishme është Ministria për Punë të Brendshme sepse Policia është ajo që furnizon prokurorinë dhe gjykatat me material inkriminues. Nëse Ministria e Brendshme do të udhëhiqej nga LDK-ja, Ministria e Drejtësisë që sipas Baba Vangës Kosovare do të udhëhiqej nga LV-ja, do të merrte material selektiv e që do të mund ta kompromentonte punën e prokurorive dhe gjykatave. Policia e Kosovës është 100 për qind nën kontroll të Ministrisë së Brendshme kurse prokuroritë dhe gjykatat janë nën pronësi të përbashkët të presidentit dhe të Qeverisë. Pra në rastin e parë kemi 100 për qind vendimmarrje kurse te Ministria e Drejtësisë kjo vendimmarrje do të ndahej midis presidentit dhe kryeministrit. LV-ja duhet t'i marrë ose të dy ministrinë, ose duhet t'i lë këto ministri LDK-së. Albin Kurti më herët ishte shumë i vendosur për këtë dhe shumë gjëra të tjera por tani, pasi hyri në atelen apo studionin e "skulptorit" Kosnet ka filluar të shndërrohet në një bucelë që ka shumë dallime nga Albini i mëparshëm, jo nga pamja e jashtme por nga përmbajtja. Ambasadori Kosnet tha se Albini

është shumë inteligjent gjë që është shumë e vërtetë. Ambasadori Kosnet tha se Albini është i matur që mund të ndodhë në të ardhmen. Ambasadori Kosnet kërkoi trajtim kushtetues për Listen Serbe e që u pajtua edhe Albini sikur që kërkoi që Albini të ketë qasje konstruktive në raport të bashkëpunimit me presidentin Thaçi që nënkupton se Shima është ende lojtar në të cilin llogarisin ndërkombëtarët. Albin Kurti është shumë inteligjent sipas Kosnet, unë do të shtoja se është shumë i mençur dhe shumë patriot sikur edhe i pakorruptuar por bisedimet me Serbinë, ose do ta bëjnë Hasan Prishtinë (pa të keqen e Agimit) ose, siç më tha një mik imi e që është njëri ndër intelektualët më të kompletuar shqiptar, do ta ul pazarin më poshtë se Hashim Thaçi. Unë e dua Albinin si Hasan Prishtinën dhe, për aq sa më punon koka (nuk jam edhe aq mirë me shëndet), Albini kurrë nuk do të veprojë në dëm të interesit të vendit dhe të kombit. Madje edhe si kryeministër i Shqipërisë së Veriut!

Jo, nuk ka vdekë o Shaban Polluzha: LDK-ja po konsideron se vetëm mungon një fjalë e Albin Kurtit dhe Isa Mustafa bëhet president. Thuaja se paska vdekur Hashim Thaçi - Shima! Madje, në çastet e triumfalizimit dhe ejakulimit të parakohshëm po bëjnë plane ku ta hedhin hirin e kufomës politike të Shimës; LDK-ja preferon ta dërgojnë në Hagë, në Gjykatën Speciale kurse LV-ja si mbështetës i prodhimeve vendore më shumë e preferon Dyzin apo Gërdocin. Po bëjnë llogari qyfte për faktin se, po nuk deshi opozita, kjo pozitë kurrë nuk do të sigurojë kurumin e nevojshëm për proces të votimit të presidentit, 80 të pranishëm në Kuvendin e Kosovës në momentin kur votohet. LDK-ja llogarit në dy (2) vota të dhunuesit të diplomacisë kosovare e që bëjnë gjithsej 79 vota, janë të pamjaftueshme. Mendja ma thotë se Isa Mustafa llogarit në miqësinë me Fatmir Limën për sigurimin e kuorumit. Do të krijohet një situatë sikur kur Hashim Thaçi dhe mbështetësit e tij të LDK-së, tërë shikimin e drejtonin te dyert hyrëse të Kuvendit në pritje të Alma Lamës dhe Margarita Kadriut të cilat, sikur në Baladën e Doruntinës hynë në sallë për të përfunduar, me aq shumë plagë në Ambasadën në Romë dhe Terminalin në Bresje. A do të përsëritet histo(e)ria edhe në vitin 2021? Është kohë e gjatë deri atëherë dhe unë nuk kam guxim të parashikoj për atë kohë! Milaimi mundet, gjithsesi! Një gjë e kam të qartë, presidentin e ardhshëm nuk do ta zgjedhë pozita, por opozita dhe, në të njëjtën kohë, kjo opozitë kur të dojë mund ta rrezojë Qeverinë. Nëse këtë do ta bënte në dy vjetët e ardhshëm do të ishte hapje e varrit për vetë opozitën! Uroj që koalicioni qeverisës të bëhet sa më parë! Krejt në fund, pozita do të bënte gabim të madh nëse mendon se ka mbaruar punë me Hashim Thaçin - Shimën! Shpejt, në prill, do të bindet, nëse jo edhe më herët!

Avokati i Popullit: Kemi pranuar vendimin e Kushtetueses për pezullimin e Ligjit për paga

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, gjatë prezantimit të rezultateve të institucionit për vitin 2019, ka deklaruar se janë trajtuar mjaft probleme, duke përfshirë tri shtyllat e shtetit, veçmas në fushën e legjislacionit që, sipas tij, ende nuk po gjen zbatim të plotë të ligjeve. Numri i ankesave të paraqitura në Institutin e Avokatit të Popullit për vitin 2019 është 1 876 sosh, ndërsa numri i rasteve të hapura për hetim nga ankesat e paraqitura kanë qenë 878, ndërsa rastet e hapura Ex Officio 51.

Sa i përket sistemit gjyqësor, Jashari ka thënë se vazhdon të ketë zvarritje të shqyrtimit të lëndëve që paraqet shkelje të drejtave të njeriut. Ai ka përmendur disa raste me rëndësi të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. "Kosova vazhdon të përballet me këto probleme, duke u nisur ende me problemin e legjislacionit në vend që konsiderohet një prej shqetësimeve kryesore gjatë punës sonë dhe trajtimit të çështjeve që kemi pasur në proces. Për shkak se një pjesë e madhe e ligjeve që nxirren nga Kuvendi i Kosovës ende nuk janë të harmonizuara mes

vete dhe, e dyta, ende vazhdon të mos ketë një kodifikim të së drejtës që përbën një prej problemeve më serioze në funksionimin e së drejtës, i cili afekton gjithë sistemin e drejtësisë, duke pamundësuar zbatimin adekuat të ligjeve", u shpreh Jashari. Sipas tij, ekzekutivi nuk ka përmirësime sa i përket llogaridhënies dhe përgjegjësisë së autoriteteve ekzekutive.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Dragashit prijnë në listën e institucioneve më të përgjegjshme për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa institucionet më mosbashkëpunuese janë Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, ajo e Punëve të Brendshme, MASHT-i dhe Ministria e Financave dhe prej institucioneve lokale është Komuna e Prishtinës.

Avokati i Popullit ka përmendur edhe dy ligjet, atë për Zyrarë Publikë dhe për Pagat, që janë pezulluar nga Gjykata Kushtetuese me inicim e Avokatit të Popullit.

Ai ka thënë se nga kushtetuesja kanë pranuar vendimin për pezullimin e Ligjit për paga.

Jashari ka përmendur edhe rastet më të rëndësishme të cilat



janë trajtuar gjatë vitit 2019. Sipas tij, është trajtuar një rast me rëndësi për trajtimin e barabartë të pensionistëve nga ana e bankave komerciale në

Kosovë për ofrimin e shërbimeve të kreditit bankar. Po ashtu, rasti tjetër, sipas tij, ka qenë një me detyrimet pozitive të shtetit, përkitazi me mbrojtjen nga

dhuna në familje për të drejtën në jetë.

Jashari ka shtuar se është trajtuar edhe çështja e fëmijëve në situatë rruge.

Osmani mirëpret zgjedhjen e Auditorit të Përgjithshëm në Maqedoninë e Veriut



PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka mirëpritur zgjedhjen e Maksim Acevski në krye të Entit Shtetëror të Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Me këtë rast, Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, përmes një telegram urimi ka përgëzuar homologun për zgjedhjen në krye të Entit Shtetëror të Revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Jam i sigurt se do të ndajmë përvoja të shumta dhe të ndryshme nëpërmjet bashkëpunimit tonë dypalësh. Ka një numër

të konsiderueshëm çështjesh që kërkojnë shkëmbim të mendimeve, pikëpamjeve dhe ekspertizave me interes të ndërsjellë", ka deklaruar Osmani. Ai ka shprehur gatishmërinë për ta mirëpritur në një vizitë zyrtare në Prishtinë kryetarin e Entit Shtetëror të Revizionit në Maqedoninë e Veriut, Maksim Acevski. Maksim Acevski është zgjedhur në krye të Institutit Suprem të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, me 81 vota të deputetëve të Parlamentit të Maqedonisë.

Qeveria shpronëson pronat për ndërtimin e "Parkut të Biznesit"


PRISHTINË, 18 DHJETOR (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar propozimvendimin për shpronësimin me interes publik të pronave të paluajtshme të ish-ndërmarrjes "OBP Produkt" zona Kadastrale Polac i Ri, Skenderaj, të cilat preken nga realizimi i projektit

"Ndërtimi i Parkut të Biznesit". Këtë vendim e ka argumentuar ministri në detyrë i MMPH-së, Fatmir Matoshi. "Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i propozon qeverisë që të nxjerrë vendim me të cilën miratohet shpronësim me interes publik të pronave të paluajtshme të ish-ndërmarrjes

'OBP Produkt', Zona Kadastrale Polac i Ri Skenderaj, të cilat preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i Parkut të Biznesit'. Qeveria nuk do të ketë asnjë implikim buxhetor pasi që ky shpronësim do të bëhet nga Komuna e Skenderajt", është shprehur Matoshi.



Ndryshimet klimatike nuk kanë nevojë për vizë Shengen



Nga Majlinda BREGU,
sekretare e përgjithshme e
Këshillit për
Bashkëpunimin Rajonal

Albert Ajnshtajni dikur ka thënë: "Shikojeni me vëmendje natyrën dhe do ta kuptoni gjithçka më mirë". Natyra dhe planeti ynë janë në rrezik.

Asnjëherë tjetër nuk mund të pajtohesh me këtë thënie sesa në këto çaste, kur nga dritarja e zyrës sime po përpiqem ta shoh qytetin e Sarajevës, të cilin e kam mbuluar mjegulla e dendur. Tani është çasti i duhur! Ditët e fundit Sarajeva u rendit në vendin e parë të listës së 10 kryeqyteteve më të ndotura të botës. Madje ajo ua kaloi edhe qyteteve super të mëdha, si: Deli, apo Mumbai. Fatkeqësisht, Sarajeva nuk është kryeqyteti i vetëm i Ballkanit Perëndimor në atë listë. Pas saj vijjnë menjëherë Beogradi dhe Shkupi, që renditen në vendin e shtatë dhe të tetë. Vitin e shkuar gjashtë qytete të rajonit ishin në listën e 10 qyteteve më të ndotura, ndërkohë që dimri këtë vit sapo ka filluar.

Që të kuptohet më mirë çështja: qytetarët që jetojnë në Ballkanin Perëndimor humbin mesatarisht rreth 1.3 vjet jetë për shkak të ndotjes së ajrit, i cili është në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe faktori përgjegjës për rreth një në pesë vdekje të parakohshme në 19 qytete të Ballkanit Perëndimor.

Numri i përgjithshëm i vdekjeve të parakohshme për shkak të ndotjes së ajrit në qytete është pothuajse 5 000 vdekje në vit. Mjaft termocentrale të vjetra prodhojnë energji të lirë, e cila vjen me një kosto të lartë për shëndetin e njerëzve - çdo vit rreth 21 000 vdekje të parakohshme mund t'i atribuohen ndotjes së ajrit nga familjet. Sektori i transportit, që është edhe një emetues kryesor i dyoksidit të karbonit, është përgjegjës për 7 për qind të të gjithë emtimeve në rajon. 13 për qind e të gjitha vdekjeve të parakohshme të shkaktuara nga ndotja e ajrit i atribuohen transportit. Ka sinjale mjaft të qarta që veprimi kundër ndryshimeve klimatike, apo Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, është në fakt jo vetëm skajshmërisht e nevojshme, por edhe madje tejte e vonuar.

Barometri ynë më i fundit i Ballkanit tregon se 84 për qind e qytetarëve të rajonit i perceptojnë ndryshimet klimatike si problem për ta. Nëntë nga dhjetë

veta mendojnë se ndotja është problem në komunitetin e tyre. Pavarësisht nga kjo, 32 për qind e qytetarëve thonë se nuk kanë vullnetin apo mundësinë që të bëjnë zgjedhje më miqësore ndaj mjedisit në konsumin e tyre të përditshëm. Numri i bizneseve që kanë ndërmarrë disa masa për ta zvogëluar ndikimin e dëmshëm mbi mjedisin ka rënë me 13 për qind krahasuar me vitin 2017 dhe tani është në nivelin 64 për qind.

Kjo do të thotë që ne duhet të bëjmë më shumë për ta rritur nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarët, pra secili prej nesh, përfshirë këtu edhe fëmijët, mund dhe duhet të bëjnë më shumë për ta sjellë ndryshimin. Pavarësisht nëse doni ta pranoni apo jo, por e vërteta është se kjo çështje na ndikon të gjithëve dhe për këtë arsye duhet të bëhemi bashkë. Edhe hapat e vegjël ndihmojnë shumë. Zvogëlimi i qeseve apo ambalazheve plastike, kujdesi që tregojmë që plehrat tona të mos ndotin lumenjtë, malet tona, fushat e pyjet, që ato të jenë të pastër, t'i trajtojmë siç duhet mbetjet, t'u kthehemi ushqimeve të përgatitura në shtëpi, të shtypim më pak etj. Një udhëtim prej mijëra kilometrash fillon me hapin e parë që ti bën.

Ndryshimi i klimës dhe natyra nuk i njohin kufijtë që përcaktojnë njerëzit. Erërat fryjnë, ujërat

rrjedhin, dielli djeg, tërmetet tundin, pavarësisht kufijve apo ndarjeve administrative që krijojmë ne. Sfidat botërore mjedisore do të kenë dhe, në fakt, tashmë kanë filluar ta kenë ndikimin e tyre edhe në Ballkanin Perëndimor, ashtu si edhe kudo tjetër nëpër botë.

Gjatë dekadës së fundit, pothuajse 12 milionë qytetarë në Evropë janë prekur nga përmbytjet apo thatësira të cilat kanë shkaktuar pothuajse 2 000 të vdekur. Ballkani Perëndimor, Serbia dhe Bosnja-Hercegovina, në veçanti, e kanë përjetuar vetë këtë lloj fatkeqësie në vitin 2014, kur përmbytjet e tmerrshme ua morën jetën shumë njerëzve, lanë qindra të tjerë pa shtëpi, shkatërruan të mbjellat, pronat dhe infrastrukturën, duke sjellë humbje të mëdha në njerëz dhe burimet financiare.

Ndryshimet klimatike janë realitet aktual dhe i pranishëm. Injorimi i sfidave më të mëdha të njerëzimit vetëm sepse ne besojmë se duhet të trajtojmë çështje më imediate pranë nesh nuk do të bëjë që të shmangen këto fatkeqësi.

Duke mos vepruar për ndryshimet klimatike do të kemi bërë hapa pas dhe do të rritet çmimi i një jete më të mirë deri aty ku ne të mos e përballojmë dot. Ndikimi i ngrohjes globale po e transformon mjedisin tonë edhe tani që po flasim duke rritur

frekuencën dhe intensitetin e ngjarjeve të motit ekstrem. Sot 5 për qind e popullatës evropiane preket nga kjo gjë, por deri në vitin 2100 kjo shifër do të arrijë deri në dy të tretat, apo deri afër 70 për qind! E mos bëni gabimin të mendoni që këto shifra nuk do të përfshijnë edhe vetë Ballkanin. Ndryshimet klimatike nuk kanë nevojë për vizë Shengen.

Unë mund të vazhdoj edhe me fakte të tjera që do të na trembnin të gjithëve. Por mendoj se kaq mjafton për të dhënë një panoramë të qartë të situatës në të cilën gjendemi. Ajo që duhet të bëjmë tani është të veprojmë. Është koha e duhur që të bashkohemi e ta bëjmë hapin e duhur drejt një mjedisi më të mirë e më të shëndetshëm për të gjithë ne. Ashtu si edhe në shumë fusha të tjera, integrimi rajonal në këtë aspekt është i nevojshëm, madje është kyç për vetë mbijetesën tonë. Sepse pa integrimin rajonal çdo vend mbetet vetëm duke bërë përpjekje që nuk mund të arrijnë kurrë të kenë ndikimin e mjaftueshëm për mbrojtjen e qytetarëve të vet.

Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës, gjithnjë ka qenë e gjithnjë do të jetë i tillë. Ne, pa asnjë mëdyshje, duhet ta tregojmë këtë gjë. Dhe do të fillojmë duke lënë pas iluzionet që duhet të merremi me prioritete të tjera. Sepse kjo do të na kushtojë shumë.

Trajtimi i klientit brenda ambientit biznesor



Gentrit KADROLLI

Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve vazhdimisht investojnë në faktorin njeri falë trajtimit dhe shërbimit që ua bëjnë klientëve të tyre, por e njëjta gjë nuk ndodh te pjesa tjetër e bizneseve, sepse trajtimi dhe shërbimi i tyre lë shumë për të dëshiruar. Shpeshherë ndodh kur klientët hyjnë në ambientet e bizneseve për herë të parë për t'u interesuar për produkte sado që hapësira të jetë e madhe brenda atyre ambienteve dhe sado i mbushur apo i rregulluar të jetë ambienti brenda, ndodh që klientët shumë shpejt të përfundojnë jashtë. Mundësitë që klientët të kthehen prapë dhe të hyjnë në atë biznes apo thënë ndryshe të na japin rastin e dytë për bashkëpunim janë të vogla. Pyetja që duhet t'i bëjmë vetes

pas kësaj është: pse ndodh kjo? Janë një varg arsyesh pse klientët mund të veprojnë në këtë mënyrë. Njëra prej arsyeve mund të jetë komforti termik, arsye tjetër mund të jetë shkak i mënyrës së renditjes së produkteve e shumë arsye të tjera. Mirëpo, arsyeja më e madhe ka të bëjë me qasjen e raportit me klientin, respektivisht fytyra e parë të cilën klientët e shohin brenda një ambienti biznesor.

Pse ndodh kjo?

Klientit që hyn brenda nuk ka se kush t'i urojë mirëseardhje. Klientin nuk ka kush ta pyesë se çfarë ndihme i duhet. Do të thotë, mungon gatishmëria për të ndihmuar. Ndodh kjo për shkak të mosdhënies së alternativave të ngjashme. Ndodh kjo sepse klientin nuk ka se kush ta orientojë se cili sektor në cilin drejtim është. Ndodh kjo kur klientit nuk ka se kush t'i tregojë se ku gjendet dhoma e provës nëse kemi të bëjmë me biznes të veshmbathjeve. Ndodh kjo sepse, edhe në qoftë se ndonjëri nga stafi është shfaqur për të na ndihmuar, qëndron aq afër nesh saqë, nëse jemi

në shoqëri të ndonjë miku apo familjari me të cilin kemi dalë për të bërë blerje apo thjesht për t'u interesuar rreth ndonjë produkti, e kemi të pamundur të diskutojmë rreth produktit, ngaqë të shkaktohet jorehati për shkak të afërsisë dhe përcjelljes hap pas hapi.

Nëse të gjitha këto dhe shumë gjëra të tjera do të bëheshin në një mënyrë tjetër ku klienti me të hyrë brenda në ambient duhet t'i urohët mirëseardhje dhe të pyetet se çfarë mund t'i ndihmojmë, të shfaqim interesim për t'i kuptuar nevojat e tij, të largohemi në një distancë të mjaftueshme duke i bërë të qartë klientit se nëse ka nevojë për ndihmë atëherë ne jemi këtu dhe krejt në fund t'i falënderojmë që na vizituan edhe nëse nuk bën blerje. Kështu klienti do ta ndiente veten më të respektuar dhe më të vlefshëm.

Dëgjimi dhe kuptimi, ajo çfarë klientët duan

Të qenit dëgjues i mirë na ndihmon në shumë aspekte, siç mund të na ndihmojë të kemi një familje më të bashkuar, t'u

shmangemi konflikteve dhe keqkuptimeve, të mirëkuptohemi me kolegët në punë dhe në fund të qenit dëgjues i mirë na ndihmon shumë për ndërtimin e besimit në raport me klientin. Por çfarë saktësisht nënkuptojmë me dëgjues të mirë kur kemi përballë një klient. Nëse pyesim njëri-tjetrin se sa jemi dëgjues të mirë, shumë prej nesh themi që jemi dëgjues të mirë. Do të thotë kemi durimin të dëgjojmë tjetrin derisa të përfundojë atë se çfarë ka për të thënë. Nga përvoja e gjatë me njerëzit në përgjithësi, kam parë që janë dy karakteristika më të theksuara kur e dëgjojmë personin që kemi përballë: heshtim derisa tjetri të përfundojë dhe në një mënyrë ne i lëmë të trupit tonë, lëvizjeve tona të kokës, syve apo edhe frymëmarrjes që jemi duke përcjell rreth asaj se çfarë janë duke thënë. Nga studime të shumta që bëhen rreth asaj se deri në çfarë niveli shkon ky dëgjues i mirë, rezultatet inkorporojnë elemente shtesë, gjë që na tregon se vetëm dy elementet e lartcekura nuk mjaftojnë, por që kombinimi i tyre me elemente të tjera siç janë

parashtrimi i pyetjeve rreth asaj se çfarë jeni duke dëgjuar, nëse jemi duke e prezantuar një produkt, ndërhyrje duke parashtruar pyetje rreth mënyrës së pagesës, përsëritjes së ndonjë elementi të produktit apo pyetje rreth transportit, si dhe pyetje të tilla si këto nuk e pengojnë atë që flet, por janë shenja lajmëruese për shitësin që jemi duke e dëgjuar me vëmendje dhe jemi me të vërtetë të interesuar dhe shumë të fokusuar në atë çka po dëgjojmë.

Gjithashtu, fokusimi që biseda të marrë kahe më miqësore dhe jo të veprohet gjithnjë me ballafaqim argumentesh dhe kundërgumentesh është element shtesë i një dëgjuesi dhe kuptuesi të mirë. Pikërisht ndërhyrjet e tilla me pyetje dhe qasje të ngrohtë e bënë që ta dallosh dëgjuesin më të mirë nga një dëgjues mesatar. Me këtë, gjithashtu, plotësohet ajo çfarë klienti synon. Të dëgjohet mirë dhe të kuptohet mirë dhe jo të kuptohet dhe të dëgjohet sa për të përgatitur përgjigje, sepse nëse veprohet në këtë mënyrë gjithçka mund të mbetet gjysmake në raport me të.

Johnson përjashton çdo shtyrje të Brexit-it

LONDËR, 17 DHJETOR - Kryeministri britanik Boris Johnson sinjalizoi se nuk do ta zbusë qëndrimin e tij ndaj çështjes Brexit tani që ka shumicën në Parlament. Ai po përpiqet të përjashtojë çdo zgjatje të afatit për arritjen e një marrëveshjeje tregtare me Bashkimin Evropian, që është

fundi i vitit 2020. Zyra e Johnsonit thotë se qeveria do të fusë një klauzolë në projektmarrëveshjen për daljen nga BE-ja që përjashton zgjatjen e negociatave tregtare përtej vitit të ardhshëm. Kjo nënkupton se Britania mund të largohet pa marrëveshje në

fillim të vitit 2021, diçka që i alarmon shumë biznese britanike. Ligjvënësit britanikë janë mbledhur të martën në Parlament për herë të parë që nga zgjedhjet e përgjithshme të javës së kaluar, dhe votimi i parë për projektligjin në Dhomën e Komuneve do të zhvillohet të premten.



Në procesin e shkarkimit të mundshëm, Shtëpia e Bardhë kthen vëmendjen te Senati

Shtëpia e Bardhë po e kthen vëmendjen te Senati me shumicë republikane që do të luajë rolin e një jurie të një procesi gjyqësor që do të vendosë për fatin e presidentit në janar, derisa Dhoma e Përfaqësuesve pritet t'i miratojë akuzat për shkarkimin e mundshëm të presidentit, Donald Trump këtë javë



UASHINGTON, 17 DHJETOR - Ndërsa Dhoma e Përfaqësuesve pritet t'i miratojë akuzat për shkarkimin e mundshëm të presidentit, Donald Trump këtë javë, Shtëpia e Bardhë po e kthen vëmendjen te Senati me shumicë republikane që do të luajë rolin e një jurie të një procesi gjyqësor që do të vendosë për fatin e presidentit në janar. Trumpi dhe aleatët e tij po përgatiten për një mbrojtje të shpejtë dhe agresive, me objektivin për të sfiduar demokratët e opozitës, ka njoftuar voa. Dhjetori është zakonisht muaj festash dhe hareje. Por Shtëpia e Bardhë po bëhet gati për betejë. Këtë javë, Dhoma e Përfaqësuesve e kontrolluar nga demokratët, pritet të votojë për miratimin e akuzave për abuzim me pushtetin dhe pengimin e Kongresit ndaj presidentit Donald Trump. Trumpi do të përballet me gjyq në Senat, ku demokratët kërko-

jnë dëshmi të tjera, përfshirë nga shefi i Personelit në detyrë, Mick Mulvaney dhe ish-këshilltari i Sigurisë Kombëtare, John Bolton. "Ata mund të paraqesin informacion që e shfajëson presidentin Trump. Por mund edhe ta inkriminojë atë. Sidoqoftë duhen dëgjuar", thotë udhëheqësi i pakicës demokratike në Senat, Chuck Schumer. Deri tani, strategjia e Shtëpisë së Bardhë ka qenë të bllokojë dhe t'i quajë hetimet një 'proces të sajuar partiak', që ka efikas për të ruajtur mbështetjen e bazës për Trumpin. "Për sa kohë që ai ka mbështetjen e bazës, senatorët mund të mendojnë 'nuk më leverdis të dal kundër presidentit, nëse do të kandidoj për t'u rizgjedhur'", thotë Todd Belt, i Universitetit "George Washington". Tani që procesi kalon te Senati i udhëhequr nga republikanët, strategjia e Shtëpisë së Bardhë po ndryshon. Ata po punojnë me republikanët kryesorë për

ta mbyllur procesin me shpejtësi dhe të kufizojnë dëmin politik. "Kam dëgjuar Mitch McConnell. Kam dëgjuar Lindsey Graham. Mendoj se janë në një mendje. Do të bëj ç'të duan ata. Nuk ka rëndësi", tha presidenti Trump duke iu referuar kreut të shumicës republikane në Senat dhe kreut të Komisionit juridik të Senatit. Senatori McConnell është angazhuar për një "koordinim të plotë" me administratën.

Kritikët e akuzojnë se ka shkelur detyrimin për të qenë i paanshëm. "Kjo lloj strategjie ka funksionuar më parë për McConnell. Ai e shpreh se ku qëndron besnikëria e tij, se çfarë do të bëjë dhe çfarë nuk do të bëjë. Prandaj ai ka bindjen se kjo është ajo që duan republikanët", thotë Vanessa Beasley e Universitetit Vanderbilt. Një tjetër strategji: të vazhdojnë sulmet ndaj kandidatit

presidencial Joe Biden, duke e quajtur të korruptuar se lejoi të birin të bënte pjesë në bordin e një kompanie ukrainase të energjisë, kur ishte vetë nën-president. Akuzat mund ta dëmtojnë Bidenin. "Ju nga ana tjetër dërguat djalin atje, të punonte për një kompani gazi", thotë një votues. Joe Biden i ka shpërfillur kërkesat që ai të dëshmojë në gjyqin e presidentit Trump, duke e quajtur një manovër për të larguar vëmendjen.

Dënim me vdekje për ish-udhëheqësin e Pakistanit, Musharraf

ISLAMABAD, 17 DHJETOR - Një gjykatë speciale në Pakistan gjeti fajtor ish-Presidentin dhe sundimtarin ushtarak Pervez Musharraf për tradhti të lartë dhe e dënoi atë me vdekje. Kjo është hera e parë që një diktator ushtarak gjykohet dhe dënohet nga një gjykatë pakistaneze. Musharraf, i cili aktualisht po trajtohet në një spital të Dubai, erdhi në pushtet përmes një grushti ushtarak në vitin 1999. Veprimet e tij u përligjën fillimisht nga gjykatat e më pas nga parlamenti. Por shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme në vitin 2007 bëri që ndaj tij të ngriheshin

akuza. Çështja ndaj Pervez Musharrafit është zvarritur nëpër gjykata që nga viti 2014, kohë që daton me ngritjen e akuzave ndaj tij. Në vitin 2016 ai u lejua të largohej nga vendi për trajtim mjekësor, falë asaj që besohet se ishte presion i ushtrisë së fuqishme të vendit. Organet e drejtësisë së Pakistanit i kërkuan disa herë Musharrafit të kthehej për të dëshmuar. Por ish-presidenti përmendte gjendjen shëndetësore si arsye për të mos u kthyer. Në fillim të këtij muaji nga një spital në Dubai Musharraf shprehu mosbesim ndaj procesit

gjyqësor duke thënë se po viktimizohej. Partitë kryesore të opozitës në vend e përshëndetën vendimin e gjykatës duke e cilësuar si një mburojë kundër çdo grushti shteti në të ardhmen. Më shumë se gjysmën se ekzistencës së tij si shtet Pakistani e ka kaluar nën sundimin e drejtpërdrejtë ushtarak. Bilawal Bhutto Zardari, udhëheqës i Partisë Popullore të opozitës dhe djali i ish-kryeministres së vvarë Benazir Bhutto, shkruante në rrjetin social Twitter "demokracia është hakmarja më e mirë". Qeveria, e cila shihet si e afërt me ushtrinë, nuk ka bërë ende një



deklaratë zyrtare. Megjithatë një nga ministrat e kabinetit qeverisës shprehu rezerva lidhur me vendimin. "Ne duhet të bashkojmë vendin.

Përse të merren vendime që e përçajnë vendin dhe institucionet?!", shkruante Fawad Chaudhry, ministër për Shkencën dhe Teknologjinë.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (9)

NËNTË USHTARË TË UÇK-së NË DUAR TË FORCAVE ARMIKE



LULZIM SAHITI

Pas Drinit mandej kanë hyrë në grupe të vogla edhe ushtarë të tjerë të vetorganizuar. Në këtë ditë kanë kaluar pritën Xhevdet Mekani nga Drenovci dhe Mensur Zyberaj "Pesëqinshi" nga Bellacërka duke u tërhequr nëpër fshatin Lubizhdë të Hasit, mandej kalojnë në Romajë dhe shkojnë deri në Krushë të Madhe. Pas luftimeve të ashpra, deri në orët e vona të mbrëmjes kishin kaluar pritën edhe Elbasan Shoshaj nga Leskovci (Prizren) së bashku me vëllanë, Namik Shoshaj dhe bashkëluftëtarin e tyre Shukri Xhemaj nga Leskovci. Këta në orët e mbrëmjes depërtojnë në fshatin Lubizhdë, ku edhe këtu hasin në pritën tjetër të armikut, por arrijnë me sukses të kalojnë, mandej vazhdojnë në Kabash dhe nga aty shkojnë në Rogovë të Hasit ku qëndrojnë dy net në një shok i tyre, me mbiemër Shala.

Në ndërkohë, pas rezistencës së bërë në lugun e Pashtrikut, një grup i përbërë prej gjashtë ushtarëve: Jemin Kelmendi nga Bellacërka (Rahovec), Shaban Vehapi nga Zatriqi (Rahovec), Xhevshet Berisha nga Carravrani (Malishevë) - i plagosur në këmbën e majtë, Uka Gashi nga Vërmica (Malishevë), Vesel Krasniqi nga Drenovci dhe luftëtarin Bedri Hysenaj "Rrusta" nga Petrova e Shtimes, arrijnë të kalojnë duke u tërhequr nga zona e rrezikshme. Këta hyjnë ndërmjet fshatit Lubizhdë dhe Kushnin. Mandej shkojnë në Romajë të Prizrenit. Bedriu atë ditë, duke çarë rrethimin, në luginën e Pashtrikut ishte plagosur në dorën e majtë. Në fshatin Romajë një qytetar i kishte strehuar për dy-tri orë, mandej kishin vazhduar rrugën për Rogovë të Hasit, pastaj kishin dalë tek Ura e Hasit te magjistralja Prizren - Gjakovë dhe kishin mbërritur në fshatin Celinë të Rahovecit. Këtu u është dhënë ndihma e parë nga ushtari i UÇK-së, Ramadan Danaj, i cili kishte sjellë një ekip mjekësor për pastrimin e plagëve të të plagosurve. Mandej kanë vazhduar rrugë-

timin për Krushë të Madhe deri në Reti (Rahovec), ku më 17 dhjetor 1998 janë takuar me komandant Drinin. Nga këtu, Bedriu ka vazhduar rrugën për Pagarushë, ku i është pastruar plaga nga dr. Agim Hazrolli dhe ekipi i tij mjekësor. Në ndërkohë ka udhëtuar në Novosellë, ku ishte Shtabi i Përgjigjëm i UÇK-së dhe nga këtu ka shkuar në Shalë të Lipjanit, ku është operuar nga dr. Fitim Selimi dhe dr. Abdullah Fazliu. Më 21 dhjetor 1998 Bedriu arrin në Luzhak, në bazën e Batalionit të Policisë Ushtarake të Zonës Operative të Nerodimes.

Pas shpërthimit të sulmit brutal armik, Hashim Gashi nga Drenovci i Rahovecit ka rezistuar bashkërisht me luftëtarët e tjerë nga ana e Rahovecit, mirëpo gjatë tërheqjes nëpër luginën e kobshme të Pashtrikut, shkëputet nga shokët e luftës. Mandej, i vetmuar ngjitet bjeshkëve të Lubizhdës. Atje

rreth orës 12:00 shkon në këtë drejtim ushtari i ri, Bekim Berisha nga fshati Dellovë i Klinës. Ai aty takohet rastësisht me Hashimin dhe këtë natë e kalojnë së bashku duke bredhur nëpër bjeshkë nga një vend në tjetrin. Kështu kanë qëndruar në ambient të hapur tri ditë e dy net, ndërsa më 16 dhjetor 1998, rreth orës 19:00, kanë hyrë në Kushnin. Një banorit lokal në fshat i kërkojnë ushqim, por ky i refuzon. Pak më tutje, familja tjetër u jep ushqim për të ngrënë, me ç'rast u sjell edhe qumësht të ngrohtë. Luftëtarët e lirisë gjatë rrugëtimit të tyre ballafaqoheshin me sfida nga më të ndryshmet. Në mesin e vendbanimeve etnikisht shqiptare, sidomos fshatarët e zonës kufitare kishin frikë nga reprezaljet serbe që mund të pasojnë. Por, fatbardhësisht, kishte edhe familje të atilla që rrezikonin gjithçka dhe kujdeshin me aq mundësi sa kishin

për pjesëtarët e UÇK-së që kalonin transit nëpër këtë fshat kufitar.

Pastaj, Hashimi, i shoqëruar nga Bekimi, vazhdojnë rrugën gjithnjë këmbë deri në Romajë, ku në këtë fshat atë natë i bënë konak mësuesi Bajram, i cili u kishte ofruar mikpritje mjaft të mirë dhe bujare. Si pasojë e qëndrimit të gjatë në natyrë, Hashimi ishte mërdhirë saqë i ishin amputuar dy gishtërinj të këmbës së majtë. Meqenëse pjesa dërrmuese e luftëtarëve të lirisë tashmë ishte tërhequr, më 14 dhjetor shtatë ushtarë të UÇK-së kishin mbetur nën rrethim, prej të cilëve disa ishin të plagosur rëndë. Edhe këta rezistojnë deri në çastet e fundit. Dikur humbin kontrollin në hapësirë dhe kalojnë në një gjendje tepër të rëndë. Ishin çaste të tmerrshme. Ata më nuk ishin në gjendje të bëjnë asgjë kundër forcave armike, të cilat veçse u afroreshin. Ishin dhjetëra ushtarë serbë që

flisnin serbisht me zë të lartë. Pothuajse me ndjenja të humbura, Enver Krasniqi nga Karaqica me shtatë plagë në trup dhe Ismet Mazreku nga Malisheva, komunikojnë diç në gjuhën serbokroate, ndërsa Merita Ramadani nga Likoci, Xhavit Krasniqi nga Duga, Azem Suma nga Dimca i plagosur në dy këmbë, Blerim Spahiu nga Runiku dhe Samet Ballazhi nga Pusteniku, i plagosur në kokë, më nuk dinin se çka po ndodhë, vetëm pritnin nga çasti në çast ekzekutimin e tyre. Forcat armike fillojnë të vijnë ngadalë në drejtim të tyre. Një ushtarak serb, i shtyrë pak sa në moshë, duke ardhur teposhtë luginës, qëllonte edhe me nga një të shtënë me revole të vrarët e shtrirë nëpër borë. Atë ditë, diku tutje, forcat serbe kishin zënë të gjallë edhe dy ushtarë të tjerë: Nazmi Bellaqën dhe Sherif Bellaqën nga Pataqani i Epërm, mirëpo nuk i takojnë aty. (Vijon)



Ushtarë të UÇK-së të zënë rob duke u ngrohur pranë zjarrit në Pashtrik, nga e djathta në të majtë: Blerim Spahiu, Ismet Mazreku dhe Merita Ramadani



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



U promovua libri 'Baladë Muhaxhire' i autorit Nimon Muçaj

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Në sallën e konferencave të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës (BIRK) të martën është promovuar libri "Baladë Muhaxhire" i autorit Nimon Muçaj. Në këtë promovim morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë me bashkëpunëtorë, profesorë, studiues, intelektualë, dashamirë të librit e të kulturës, si dhe shumë të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu Tërnavë ka përgëzuar autorin e librit "Baladë Muhaxhire" të Nimon Muçajt për botimin e këtij libri, duke theksuar se kjo vepër do t'i pasurojë bibliotekat tona. "Autorit i dëshiroi shëndet e mbarësi me shpresën se edhe në të ardhmen do të na begatojë me kontribute të tjera, kurse të pranishmit i falënderoi për kohën e çmuar që kishin ndarë. Botimin e romanit 'Baladë Muhaxhire' e konsiderojmë si një mirënjohje për autorin dhe si një shlyerje borxhi e si një përkujtim, qoftë edhe në këtë masë, për të gjithë ata shpirtë të vuajtur të cilët me dhunë u detyruan t'i lëshonin vatrat e tyre dhe gjithçka tjetër që kishin. Po ashtu, e konsiderojmë edhe si një ndihmesë shtesë për brezat e ardhshëm për ta njohur, kujtuar dhe për të mos e harruar të kaluarën tonë", ka thënë Tërnavë.

Ai ka shtuar se kjo veprimtari në kuadër të BIK-ut, me kalimin e viteve, është rritur dhe zhvilluar në bazë të kërkesave



të besimtarëve të tij dhe masës së gjerë të lexuesve. "Aq sa sot Bashkësia Islame, respektivisht shtëpia botuese 'Dituria Islame' numëron të botuara mbi 200 vepra të fushave e disiplinave të ndryshme, shtojmë këtyre edhe botimin e periodikut të saj. Kështu, me shkëputjen e Sanxhakut të Nishit nga trugu i vilajetit të Kosovës, vetëm gjatë vitit 1877/78, sipas studiuesve të historisë, statistikave e botuara deri më tani flasin për spastrimin e më se 1 000 vendbanimeve shqiptare dhe për dëbimin e më shumë se 200 000 shqiptarëve. Dhe jo vetëm kaq, por gjatë viteve 1877/78 ushtria serbe, përveç shqiptarëve të Saxhakut të Nishit, kishte dëbuar nga vatrat e veta dhe shqiptarët dhe popullsinë muslimane të etniteteve të tjera edhe nga Saxhaku i Jeni Pazarit

dhe nga Mali i Zi. Shumica e këtyre të shpërngulurve u vendosën aty ku mundën dhe aty ku i hodhi vala, brenda trojeve tona shqiptare dhe në Turqi, duke u gjetur kështu në një pozitë shumë të vështirë shpirtërore, sociale dhe ekonomike", ka thënë myftiu Tërnavë.

Nga një fjalë rasti kanë mbajtur edhe dr. Hysen Matoshi dhe dr. Emin Kabashi. "Romani 'Baladë Muhaxhire' i autorit Nimon Muçaj përbën një përpjekje të rrallë ndër ne për trajtimin artistik të plagëve më të madhe të botës shqiptare në dy shekujt e fundit: dëbimin nga vatrat stërgjyshore. Romani është konceptuar në trajtën e rrëfimit kronologjik, plotësuar me reminishenca të shumta e rrëfime paralele me ngjarje të përjetuara dhe të ritreguara nga perspektiva të ndryshme narra-

tive. Përjetimi është shpërfaqje e botës emocionale e artistike, një përthyerje interesante autoriale e dhimbjes së përjetuar në kujtesën kolektive për pjesën e humbur të atdheut", ka thënë prof. dr. Matoshi, njëherësh edhe redaktor i romanit.

Kurse referuesi tjetër i këtij romani, dr. Emin Kabashi, duke folur për vlerat letrare të këtij romani, tha se ndër karakteristikat që e bënë të veçantë strukturën e romanit është përmasa e hapësirë të rrëfimit të ngjarjeve. "Janë dy-tri kaza, dy-tri vilajete, dy-tri kontinente nëpër të cilat lëvizin personazhet e romanit të tij nëpër të cilin shtrihet rrëfimi i ngjarjeve që e bënë strukturën e romanit. Lexuesi i këtij romani ndoshta për herë të parë në gjuhën shqipe edhe në romanin shqiptar përballet me një temë

pothuajse të patrajtuar fare në këtë letërsi. Tragjedia e zhbërjes së pjesës lindore të tokave shqiptare qoftë edhe në tryninë e sistemeve shoqërore në atdheun tonë e ka lënë në harresë si dëshmi artistike njëherë nga ngjarjet më tragjike të historisë sonë kombëtare. Nimon Muçaj meriton respekt për gjetjen e temës, për mënyrën e trajtimit si dhe për mbar shtrimin artistik të saj", ka thënë Kabashi.

Drejtori për Shtyp dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra ka folur për veprimtarinë e kësaj shtëpie botuese, duke potencuar mes të tjerash se deri më tani janë botuar mbi 200 tituj nga fusha të ndryshme fetare, si nga jurisprudenca, historia dhe qytetërimi islam, tefsiri, hadithi dhe fusha të tjera. Ai ka shtuar se krahas këtyre librave janë botuar edhe një sërë monografish dhe botimesh të veçanta me vlerë për histografinë, kulturën, gjuhësinë dhe letërsinë shqipe. Drejtori Shkodra ka falënderuar myftiun Tërnavë për mbështetjen e vazhdueshme që po jep për botimin e librave fetarë e shkencorë, duke u zotuar se edhe në të ardhmen do të botojnë vepra të këtilla në interes të fesë dhe shkencës.

Pjesë nga romani lexuan aktoret e njohura Muradije Muriqi dhe Safete Rogova. Në fund autori Nimon Muçaj mori fjalën duke falënderuar myftiun Tërnavë, shtëpinë botuese "Dituria Islame" për botimin e kësaj vepre si dhe të gjithë pjesëmarrësit.



'Exil' nga Visar Morina në Berlinale



PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Berlinalja, një ndër festivalet më të rëndësishme të filmit në botë, ka publikuar programin e filmave të kategorisë Panorama, pjesë e të cilit është filmi "Exil" i regjisorit nga Kosova, Visar Morina. Filmi rrëfen tregimin e

Xhaferit, një inxhinier i kimisë me origjinë nga Kosova, i cili ndihet i diskriminuar dhe i ngacmuar në vendin e punës, gjë që e zhytë atë në krizë të identitetit.

Filmi "Exile" i skenaristit dhe regjisorit Visar Morina, skenari i të cilit është shpërblyer

me çmimin prestigjioz gjerman "Lola's Gold", vjen pas sukseseve me filmin "Babai" i cili fitoi në Festivalin e Karlovy Varyt për regjinë më të mirë.

"Exile" është bashkëprodhim në mes të Komplizen Film Gjermani, Ikonë Studio

Kosovë (Yll Uka, Valon Bajgora) dhe Frakas nga Belgjika, i financuar nga: Minister of State for Culture and Media, Film - und Medienstiftung NRW, German Federal Film Fund, Belgium Film Tax Shelter, Medienboard Berlin Brandenburg, Qendra

Kinematografike e Kosovës, Eurimages, German Federal Film Board.

Filmi "Exile" sjell një kastë brilante të aktorëve, si: Sanrda Huller, Misel Matieviq, Astrit Kabashi, Valentina Dubovci, Flonja Kodheli, Getuart Hajrizaj, Ameli Kabashi.

QKK-ja organizon Javën e Filmit të Kosovës në Bujanoc

PRISHTINË, 17 DHJETOR (ER) - Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK), në bashkëpunim me Këshillin Nacional Shqiptar dhe Shtëpinë e Kulturës, për vitin e dytë me radhë organizojnë Javën e Filmit të Kosovës në Bujanoc nga data 20 deri më 24 dhjetor. Gjatë javës do të shfaqen katër filma të metrazhit të gjatë dhe dy të metrazhit të shkurtër të realizuar në vitet e fundit në Kosovë.

Java e filmit do të hapet me

filmin e propozuar nga Kosova për çmimet Oscars, "Zana" nga Antoneta Kastrati dhe do të vazhdojë me filmin "Echo" nga Dren Zherka, "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" nga Kushtrim Bekteshi, "Babai" nga Visar Morina, "Në mes" nga Samir Karahoda dhe "Shok" nga Jamie Donoughue. Filmat do të shfaqen në Shtëpinë e Kulturës çdo ditë nga ora 18:00 nën përkujdesjen e koordinatorit të projektit Nagip Tashi.

JAVA E FILMIT TË KOSOVËS NË BUJANOC

20-24 DHJETOR
SHTËPIA E KULTURËS - BUJANOC

 KOSOVO
CINEMATOGRAPHY
CENTER

E rrallë

Kafeneja më e bukur në botë

Një kafene në kryeqytetin e Hungarisë në Budapest, e quajtur Nju Jork, është nga më të vjetrat në qytet, pasi ka plot 125 vjet ekzistencë. E kotë të thuhet që në këtë vend njerëzit hyjnë për më shumë se thjesht një kafe e një ëmbëlsirë. Ndërtesa ndodhet në bulevardin kryesor të qytetit dhe pret rreth 2000 klientë në ditët më të ngarkuara.



FOTO E DITES



Një vajzë shihet duke luajtur me një armë lodër në një oborr të riciklimit të plastikës në Dhaka në Bangladesh. /Reuters/

E jashtëzakonshme

Finlandë, hidhet ideja e punës katër ditë në javë, 6 orë në ditë

Sana Marin sot është kryeministria më e re në botë, por kur ishte ministre e transportit ajo dha idenë për t'i ulur orët e punës në javë për punonjësit. Ideja e Marin është që të ketë katër ditë punë në javë, me nga gjashtë orë punë në ditë. "Pse të mos jetë ky hapi i radhës? A është tetorëshi e vërteta përfundimtare? Besoj se njerëzit meritojnë të shpenzojnë më shumë



kohë me familjen si dhe të merren me të tjera aspekte të jetës, si kultura", pati thënë ajo në gusht të vitit 2019. Marin shpresonte që propozimi i saj të bëhej realitet shumë shpejt në vendin e saj, ku orari është tetë orë në ditë për pesë ditë në javë.

BARSOLETA E DITËS



Gjakovari:

- Veshe pallton, zemër!
- Pse, a po dalim diku a?
- Jo zemër, veç unë po dal, por po du me ndalë nxemjen!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30
TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si t'i kombinoni idetë me praktikën në punë.</p>	 <p>DEMI Po e cni me hapa të avashtë sa iu përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situatën e reja.</p>	 <p>BINJAKËT Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por që do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.</p>	 <p>GAFORRJA Keni preferuar që të jeni të drejtë drejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do t'i lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.</p>	 <p>LUANI Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes së personave që do të keni përballë gjatë ditës.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Ndonjëherë mund të veproni edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.</p>
 <p>PESHORJA Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në sintoni me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.</p>	 <p>AKREPI Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni ju të drejtë për gjithçka.</p>	 <p>SHIGJETARI Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkakuar një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.</p>	 <p>BRICJAPI Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.</p>	 <p>UJORI Po mundoheni t'i modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë më ambiciozë sesa mundësitë tuaja reale.</p>	 <p>PESHQIT Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. E rëndësishme është të mos ju kapë paniku.</p>

Gabriel Garko ndryshon sërish pamjen



Gabriel Garko ndryshon sërish lokun. Pas modeleve të ndryshme që ka eksperimentuar me modelin e flokëve, tani aktori i famshëm italian është shfaqur me një pjesë flokësh të lyer blond dhe një prerje anësore. Garko, 47-vjeçar, është shfaqur me pamjen

e re në prezantimin e librit të tij 'Andata dhe ritorno', 'Vajtje dhe ardhje'. Në rrjetet sociale fansat ndahen në gjykimin e tyre për modelin e ri të aktorit të 'Nder dhe Respekt'. Disa e preferojnë brun si më parë, ndërsa disa të tjerë si kursejnë zemrat dhe pëlqimet.

Ava Max sjell këngën "Salt"



Këngëtarja e njohur shqiptare Ava Max ka publikuar këngën e re. Kënga më e re

quhet "Salt". "Salt" aktualisht është e disponueshme për publikun vetëm në versionin audio.



Nicole Scherzinger dhe Thom Evans në lidhje dashurie

Ata kanë qenë të lidhur romantikisht, pavarësisht se Nicole Scherzinger thotë se ajo është shumë e zënë për t'u lidhur me dikë. Por mund të ketë më shumë histori mes saj dhe

Thom Evansit, teksa ishin fotografuar duke shikuar me admirim njëri-tjetrin në lokalin e koktejeve në Londër. Ndërsa dyshja qëndronte pranë barit, Thom e shikonte me dashuri Nicolen.

Pas divorcit, Liam me të dashur të re



Liam Hemsworth duket se e ka harruar plotësisht Miley Cyrus. Pas divorcit, aktori 29-vjeçar ka nisur një romancë me modeluesen australiane Gabriella

Brooks. Thashethemet janë "konfirmuar" pasi Liam është fotografuar duke ua prezantuar bukuroshen 21-vjeçare prindërve të vet, Craig dhe Leonie.



Shqiptar Oseku: Mbi Nobelin, akademinë, dhe pse luajta rolin tim në një skenë të Peter Handkes

Kur u mblodhën protestuesit e parë kundër Peter Handkes në adresën Perandori Justinian nr 111, aty ku ndodhet ambasada suedeze në Prishtinë, unë isha kundër. E para, pse academia suedeze nuk është institucion shtetnor. Të shkaktosh rrëmujë para hyrjes së ambasadës, në një rrugë komikisht të ngushtë që s'ka asnjë përjasje me emrin e vet grandioz. Bah, kësaj i thonë të abuzosh kot nëpunësit dhe nevojtarët që kanë punë aty. Pastaj e dyta, edhe sikur aty të ndodhej filiala e akademisë, ç'kuptim ka. Academia suedeze është e njohur për indiferencën e studiuar me të cilën pret kritikë e përvitshme për zgjedhje të gabuar. Më 2005 u mërdhiva me plot tjerë shqiptarë e boshnjakë në një shesh të dëbortë para vetë akademisë në Stokholm, për të protestuar kundër një tjetër nobelisi pro Millosheviç, dramaturgut britanik Harold Pinter. Rezultati doli një hiç me lule. Mediat suedeze na quajtën "ballkanas të pakënaqur", thuase protesta

kundër një apologjeti të gjenocidit të ishte shije e mësuar a tipar kulturor, njësoj si kur të pëlqen byreku ta zëmë, a suflaquet. Nja dy akademikë na quajtën atë natë katundarë të Ballkanit. Të nesërmen academia kumtoi nga froni i fildishtë se kish një dallim midis letërsisë e politikës. Aq nxorrëm në dritë, aty mbaruan prurjet e protestës. Kush ka dy fije mend në krye s'del dy herë vullnetar për një vetëposhtërim të tillë. Dhe së treti, a s'është Handke ai debili i dhuntishëm që ushqehet me skandale? Ai që rigjeti libidon artistike duke dhunuar analisht historinë? Talenteve kriminele si ai pikërisht këto akte dhune u japin këllqe të shkruajë më shumë. Pse t'i jap unë frymëzim kot.

Ajo që nuk doja t'ia pranoj vetes, e që më mundonte nën sipërfaqe, ishte ambiguiteti im personal rreth Handkes. Sepse e vërteta e tmerrshme është, se mu ky pasion maniak me të cilin Handke dhunon historinë pas vitit 1996, në letërsi i është

shfaqur kur ka sfiduar konventat e artit. Ta zëmë në teatër, tek shfaqja *Offending the Audience*, ku katër aktorë pa skriptë tjetër veç udhëzimesh të përgjithshme mësyjnë verbalisht publikun me orë, duke anuluar nocionet e teatrit dhe publikut. Në premierën e vitit 1966 kritikët e shokuar e quanin shfaqjen anti-teatër, ndërsa Handke u përgjigjej se do t'u hapte sytë njerëzve në publik. Ose ta zëmë autopsia që ai i bën së ëmës, me të cilën ka qenë aq i lidhur, tek *A Sorrow Beyond Dreams* (1972). Sa autorë tjerë njeh ti që janë në gjendje t'i aviten aq fort degjenerimit trupor e mendor tek prindi? Që jo vetëm eksplorojnë vetëvrasjen si ide, se ashtu mund të del estetike, por që regjistrojnë saktësisht gërryerjen e përditshme, të pistë e ngulfatëse, të çmendisë që rëndom gëlon pas vetëvrasjes – duke u shërbyer me nënën vetjake si rast studimi? Brrr. Vetë ideja të ngrin gjakun.

Natyrisht që një njeri i cakërruar si Handke nuk mund të jetojë në paqe me botën. Jeta pas "fundit

të historisë", pas rënies së sovjetikëve dhe të murit të Berlinit, do t'i jetë dukur një idilë e padurueshme. Por Handke gjeti shpejt një tjetër arenë ku të ushqente agresionet kreative. Më 1996, Handke stepi publikun gjerman me një udhëpërshkrim nga Slllobodanistani, pashallëk i skajuar e izoluar prej sanksionesh ndërkombëtare, nën sundim të Slllobodan Millosheviçit. "Historia i bën njerëzit të poshtëra të shkëlqyer, e nga serbët ka krijuar vërtet një popull të jashtëzakonshëm", ngulmon Handke – në kohën kur serbët e jashtëzakonshëm po kryenin një gjenocid të jashtëzakonshëm në Bosnë. Sepse një sfidë nuk është e pranueshme për Handken nëse nuk është ekstreme, pra.

Që atëhere, Handke ka shkarë në ekstrem pas ekstremi. Refuzon të quajë boshatisjen e qyteteve dhe Srebrenicën gjenocid, pse s'i pëlqen ajo fjalë, disi s'është semantiksht e saktë. Handke ishte student juridiku para se të bëhej shkrimtar dhe një

regullin e artë të retorikës, e vërteta aparente nuk mohohet por shtrembërohet. Ndaj e ripagëzon gjenocidin me turli eufemizmash, vëllavrasje, incident, hakmarrje. Mirepo e përdor termin gjenocid pa ngurrim sa herë kris një pushkë në katunde serbësh. Pohon se serbët janë autoktonë, boshnjakët tradhtarë, e amerikanët kaubojë që duan koloni. Në një rast bizar, ai vjen i shoqëruar në Kosovë nën orë policore dhe konstaton "s'jam ndier kurrë më i lirë". Shqiptarët i quan "komunitet që e bashkon vetëm urrejtja antiserbe", "fëmijët shqiptarë ende pa ecur gjuajnë gur mbi serbë" – kjo mbasi ishin vrarë mbi 1700 fëmijë shqiptarë nga ushtria e policia serbe. Bëhet mik për kokë me Millosheviçin, e quan pëllumb që do bashkëjetesën, e viziton në qeli në Hagë. Transferin e tij atje e quan "turp i amshueshëm i Serbisë". Ekstremisti parimor Handke shkon gjer atje sa të kalojë në fenë serbe ndonëse është ateist; natyrisht që klerikët serbë s'i shohin kusure.

Grindja e tij me planetën Tokë, këto njëzet vjetët e fundit rreth Serbisë, e ka frymëzuar të shkruajë, e të shkruajë mirë biles. Por viteve të fundit, me moshën, ka hyrë në një si vjeshtë krijimtarie. Disa ditë para ceremonisë Nobel unë ende mendoj se kjo bishë s'do ushqyer me impulse e sensacione të reja. Çmimi Nobel i ka bërë shumë autorë si daca të nginjur, ua ka topitur talentin e penën. Të presim, them unë, pa shohim e bëjmë.

Ato ditë kam edhe një tjetër arsye shtesë për të mos hipur në autobus. Kam thurrur një teori timen konspirative pse akademia suedeze i blaton Nobelin një autori të perënduar si Handke. Rrethi i të tetëmbëdhjetëve që ndan këtë çmim është demaskuar në publik si qerthull elitari mizogjinësh, ku bëjnë namin inate të ulëta, thashethemnaja, e një përbuzje e hollë por e pafshehshme ndaj grave të akademisë. Odën e burrave në akademi s'e ha më pazari. Elitizmi dhe ajo kulla e fildishtë që i ka ruajtur prej katundarësh tashti quhet fodullëk, mendjengushtësi, e mendësi patriarkale. Dhe akademia, e cila ka patur gjithmonë një përgjigje elegante ndaj akuzash politike, s'ka gjetur dot nje mbrojtje efikase kundër këtij lloji të ri skrutinizimi.

E ku ka mënyrë më të mirë të devijosh gjithë këtë debat të rrezikshëm, se duke vlerësuar një enfant terrible që e urrejnë dhe i kanë frikën të gjithë?

Unë nuk gjej asnjë shpjegim tjetër pse pikërisht Handke. Sepse e vërteta është që Handke nuk është përkthyer në suedisht që nga viti 1996. Asnjë shtëpi botuese nuk ka dashur ta prekë

as me mashë, shkaku i serbofilisë banale. Pse kush do ta marrë në dorë një apologjet gjenocidësh, kur s'ka gjasa të fitojë? As botimet e vjetra nuk janë ribotuar. Handke nominohet çdo vit si

kandidat, midis tjerash nga akademia serbe e shkencave dhe arteve SANU, por vazhdimisht refuzohet, për arsye të vetëkuptueshme. Kur u kumtua lajmi tronditës, në dhjetor 2019, bashkëpunëtorë të jashtëm të akademisë, ata që ndihmojnë me përzgjedhje e përkthime, biles japin dorëheqje. Duket qartë, pra, se vendimi 2019 është marrë për motive jashtëletrare.

Akademia suedeze, e zënë ngusht siç është nga skrutinizimi, kërkon një diversion. Ajo di të menaxhojë perfekt akuzat politike – katundarë nga Ballkani, ne bëjmë dallim midis letërsisë dhe politikës, etj etj – dhe natyrisht që preferon këtë lloj debati, shumë më fort se debatin për llogor të burrave. Krerët e akademisë kanë marrë vendimin të nderojnë Handken pikërisht për këtë shkak. Jo për të nderuar a mbrojtur autorin e harxhuar tashmë, a jo. Por për të mbrojtur kullën e vet të fildishtë. Ata përdorin dramaturgun Handke, të joshur nga nepsi për fame, si aktor në një skenë ku regjisor është vetë akademia.

Natyrisht që unë, me këto ide, nuk kam asnjë motiv të protestoj në acar të dimrit. Gjer dy ditë ditë para ceremonisë Nobel, që tradicionalisht mbahet me 10 dhjetor, unë e kisha ende mendjen top. Ncuk, s'jam budalla. Unë s'bëhem piun në një tabelë shahu.

E pra nuk di as vetë si ndodhi që unë, në mbrëmjen e 10 dhjetorit, po mërdhija me mikrofon në dorë sërisht mbi tribunën e ngritur ad hoc në sheshin Norrmalmstorg të Stockholmit, duke folur para mëse njëmijë njerëzve. Peter Handke mbron kriminelët! Turp të keni, akademia suedeze! Ne jemi me ju, boshnjakë!

Nuk ka asnjë shpjegim logjik. Logjika ishte komplet në anën e burrave të akademisë, e të neurotikut Handke. Skripta ishte në dorën e tyre.

Veçse nganjëherë njeriu duhet ta çojë logjikën në rrs, se prej mishi e kockash jemi e na vlon gjaku. Dhe atëhere mund të ndodhë ashtu si ndodhi, që një rebelim qorr i aktorëve të godasë verbërisht në shenjë, e regjisorëve t'u ikë produksioni prej duarsh. Dhe pyetni Handken e ai do t'ju shpjegojë: rëndom jane një a dy personazhe që autori s'i ka menduar, s'i ka skicuar si duhet, nuk u ka rrokur tamam karakteret, që bëjnë kryengritje të papritur dhe devijojnë skriptën. Si ta zëmë personazhet e denja të dy ambasadorëve shqiptarë në Stockholm, Shkëndije Geci-Sherifi dhe Virgijl Kule, që nisën një ortek bojkotesh nga diplomatë.

Tash kur po shkruaj këtë, kam arritur të ndjek lajmet ndërkombëtare dhe di se të gjitha mediat e shkruara i kanë dhënë hapësirë bojkotit diplo-

matik njësoj sa ceremonisë. Mohuesi i gjenocidit për vitin 2019, njëherit edhe nobelist në letërsi, Peter Handke, tok me burrat e akademisë që kishin menduar tjetër shfaqje, kanë arsye të ndihen të frustruar. Ndërsa unë mendoj për ata protestuesit e parë, që dolën më rrugën Justiniani nr 111 në Prishtinë.

Po, ambasada suedeze ende s'ka të bëjë me çmimin Nobel. Dhe po, ajo rruga është ende komikisht e ngushtë dhe e padenjë për emrin grandioz që ka. Dhe po, Handkes së plakur do t'i ketë ëndja sigurisht edhe më tutje të ushqehet me skandale, athua i rindezin talentin. Por ata njerëzit që dolën në mënyrë spontane të protestojnë nuk janë aktorë në drama të të tjerëve, po protagonistë në dramën dhe jetën e vet. Njësoj sikur unë në Stokholm, Nënati e Srebrenicës në Bosnje, a njerëzit që mbijetuan lëkundjen e tokës në Durrës. (Po, Handke ka poshtërimë edhe për Shqipërinë, por kush lodhet.) Ata protestues kishin të drejtë. Ne duhet ta luajmë rolin kryesor në dramën tonë, pse secili është heroi i rrëfimit të vet; e jo të mendojmë se çfarë mendojnë për ne një publik ambasdash, rrugësh komikisht të ngushta me emra të mëdhenj, e shkrimtarësh hidhnakë me huje. Sepse po, ne jemi kryepersonazhet e rrëfimit tonë. Dhe ata, gjithë ata, janë publiku ynë./Exlibris





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Klubet e Superligës fillojnë lëvizjet për pranverë

Klubet elitare në Kosovë kanë filluar të përforcohen për sezonin pranveror, i cili, si kurrë më parë, do të jetë interesant si në garën për titull, po ashtu edhe për mbijetesë. Skuadra e Llapit të martën bëri një transferim të madh duke e angazhuar Egzon Krasniqin që ka shkëlqyer në dy vjetët e fundit me fanellën e Flamurtarit të Prishtinës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 DHJETOR - Edicioni vjeshtor në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka përfunduar me Ballkanin që arriti të dalë skuadra më e suksesshme në këtë fazë, derisa edhe ndeshjet e Kupës janë zhvilluar dhe tash klubet elitare janë në pushim deri më 6 janar.

Drejtuesit e klubeve të përfshira në garën për titull, por edhe ato për mbijetesë, kanë filluar lëvizjet e para. Të martën Llapit arriti ta sigurojë përforcimin e parë për sezonin pranveror. Klubi që drejtohet nga trajneri Tahir Batatina është eliminuar nga Kupa dhe ka mbetur paksa mbrapa në garën për titull, por kjo nuk e ka penguar t'i sigurojë shërbimet e futbollistit Egzon Krasniqi, i cili në dy vjetët e fundit ka shkëlqyer me fanellën e Flamurtarit të Prishtinës. Skuadra e Llapit ka njoftuar se Krasniqi ka nënshkruar kontratë për një vit e

gjysme, derisa refuzoi shumë oferta për klubin nga Podujeva. "Egzon Krasniqi gjatë dy edicioneve paraprake ishte ndër futbollistët kryesorë të ekipit të Flamurtarit, ndërsa tashmë në Llap veç është njoftuar me projektin dhe do të jetë ndihmesë e madhe e klubit bardhekaltër në edicionin pranveror", thuhet në njoftimin e Llapit. Në drejtim të kundërt mund të lëvizë sulmuesi nga Shqipëria, Sebino Plaku. Ky i fundit besohet se do të qëndrojë në klubin e Llapit, pasi ka prishur raportet me drejtuesit e klubit, derisa e paqartë vazhdon të jetë e ardhmja e yjeve të tjerë si Labinot Osmani, Behar Maliqi dhe Mentor Zhdrella.

Skuadra e Flamurtarit, pos ndryshimeve në shtabin teknik, ku drejtimin e klubit e mori Bylbyl Sokoli, është duke punuar për ta përforcuar klubin. Drejtuesit e klubit kuqezi e kanë "blinduar" Gentrit Begollin, kurse janë në bisedime edhe me Plakun dhe Osmanin e Llapit, Dardan Jasharin e

Ballkanit dhe Viktor Kukën e Ferizajit. Duarkryq nuk ka qëndruar as skuadra e Feronikelit e cila liroi shtatë lojtarë të dëshmuar në futbollistin e Kosovës: Kastriot Rexha, Astrit Fazliu, Albutrint Morina, Lulëzim Doshlaku, Haxhi Neziraj, Arbër Prekazi dhe Milosh Krkotiç. Në anën tjetër, në Drenas kanë "aterruar" Simon Loshi, Kristi Kullaj, Keith Groeneveld dhe Ilir Berisha. Ndërsa kampioni vjeshtor, Ballkani, ka arritur marrëveshje me mbrojtësin e njohur Arbër Prekazi, por zyrtarizimi i tij në skuadrën nga Suhareka do të ndodhë pasi të ndahet përfundimisht me Feronikelin. Gazeta ka mësuar se skuadra e Gjilanit është duke biseduar me tre futbollistë në mënyrë që ta ndjekë garën për titull dhe trofeun e Kupës, por marrëveshjet ende nuk janë finalizuar. Ndryshime do të ketë edhe në skuadrën e Drenicës, derisa një burim i gazetës brenda klubit kuqezi ka bërë me dije se portieri Arion Ymeri mund të jetë largimi më i madh në afatin kalimtar të dimrit.

SHKURT

Rritet vlera e Rashicës

Ylli i Përfaqësues së Kosovës, Milot Rashica, është lojtari kryesor i Werder Bremenit këtë sezon, duke marrë përsipër udhëheqjen e skuadrës gjermane në një sezon shumë të vështirë për ta. 23-vjeçari shënoi një gol të bukur në humbjen e Werderit nga Bayern Munichu në fundjavë të Bundesliga. Faqja e specializuar për vlerat e futbollistëve, "Transfermarkt", ka njoftuar se futbollisti nga Vushtrria, Milot Rashica, nga 20 milionë euro, tani vlen 35 milionë. Kjo është një rritje prej 75 përqindësh për Rashicën.

Tottenhami përgatit ofertën për Muriqin

Skuadra angleze, Tottenham Hotspur, është e interesuar për transferimin e një sulmuesi në afatin kalimtar të janarit. Trajneri Jose Mourinho është i interesuar që krahas Harry Kane të ketë edhe një tjetër sulmues, kurse mediat turke kanë zbuluar as në "radar" të klubit anglez është sulmuesi Vedat Muriqi. "Spurs" madje e ka bërë gati edhe ofertën për transferimin e shtatllartit nga Kosova, i cili po shkëlqen në fanellën e Fenerbahçes.

Besa kërkon rikthimin e tri pikëve nga federata

Besa e Pejës është kampione vjeshtore e Ligës së Parë të Kosovës në futboll. Pejanët dimërojnë me 28 pikë, një më shumë sesa vendi i dytë, Arbëria dhe dy më shumë sesa Liria. Komisari i Garave i FFK-së klubit pejan ia kishte hequr tri pikë për shkak të moskryerjes së obligimeve financiare ndaj futbollistëve të edicionit të kaluar. Mirëpo, trajneri i Besës, Miftar Rama, ka konfirmuar se janë në pritje të kthimit të këtyre pikëve. "Po presim që federata të na i kthejë tri pikët, pasi klubi ka kryer obligimet financiare ndaj lojtarëve. Nëse kjo ndodh atëherë do të ishim katër dhe pesë pikë larg ndjekësve", ka thënë Rama për "RTV Dukagjinin".

Talenti Ibrahim i nënshkruan për ekipin e parë të Leipzigit

Shqipëria dhe Kosova kanë anëmbanë botës talente dhe garantojnë një të ardhme të shkëlqyer. Këtë herë futbollisti Mehmet Ibrahim ka firmosur kontratën e parë si lojtar profesionist. 16-vjeçari që është pjesë e skuadrave zinxhir të Leipzigit në Gjermani nënshkroi kontratë me ekipin e parë. Jo vetëm kaq, por Ibrahim përfaqëson dhe kombëtaren gjermane për grupmoshën 17-vjeçare. Sulmuesi i krahit ka realizuar 4 gola dhe 1 asistim në 14 ndeshje të Kampionatit gjerman të Veriut për 17-vjeçarët. Në këtë mënyrë, Mehmet Ibrahim hedh hapin e parë madhor në karrierë. Leipzig është kthyer në njërin prej skuadrave më të mira në Gjermani, ku sezonin e kaluar e mbylli në vendin e tretë, ndërsa këtë sezon udhëheq kampionatin gjerman. Jo vetëm kaq, por ekipi gjerman konkurren edhe në Ligën e Kampioneve, ku do të përballet në raundin 1/16 me Tottenhamin.

Ferrari bën ndryshime, Vetteli dhe Leclerci të barabartë

MARANELLO, 17 DHJETOR - Pas polemikave të këtij sezoni, të Ferrari janë duke marrë masat që incidentet në mes të Sebastian Vettelit dhe Charles Leclercit të mos përsëriten vitin e ardhshëm. Gjithsesi, drejtuesit e "kokëkuqes" deklarojnë se

nuk do të ketë asnjë hierarki mes dy pilotëve dhe të dy do të jenë të barabartë në startin e sezonit të ri. Mattia Binotto, shef i Ferrarit, ka deklaruar: "Nuk do të ketë asnjë pilot të parë apo të dytë, të dy janë të barabartë. Do të jetë një vit ndryshe,

më i mirë shpresoj, pasi njihemi më shumë mes nesh. Gjithashtu, marrëdhënia mes dy pilotëve tani është në një fazë tjetër". Binotto pranon se kur nisi Botërori 2019 kishte një hierarki. "Po, Vetteli ishte pilot i parë dhe Charles i dytë, por me kalim-

in e kohës gjërat ndryshuan. Këtë vit kuptuam se ata mund të duelojnë për titullin, ndaj të dy për ne do të jenë kandidatë", ka shtuar Binotto. Këtë sezon Charles Leclerc (i katërti) u rendit më mirë se Sebastian Vetteli në renditje (i pesti), duke arritur



edhe 2 fitore dhe 7 "pole position".

Sonte zhvillohet 'El Clasico'



BARCELONË, 17 DHJETOR - Sonte (e mërkurë) nga ora 20:00 zhvillohet "El Clasico" në mes të Barcelonës dhe Real Madridit, ndeshje që konsiderohet si një nga ndeshjet më të rëndësishme dhe madhështore në futbollin botëror. Jo më kot quhet "klasike", por këtë herë sfida Barça - Real vjen më e ngarkuar se kurrë me çështje politike dhe të tjera që kanë pak lidhje me futbollin. Atmosfera është e rënduar, teksa opinioni sportiv dhe jo vetëm në Spanjë zien nga polemikat që vijnë nga vendimi për të shtyrë këtë sfidë, që duhej të luhej që në tetor. Por larg tyre duket se qëndrojnë pro-

tagonistët e vërtetë. Lionel Messi dhe Zinedine Zidane mendojnë vetëm për futbollin. Madje "Pleshti" i Barcelonës ka vetëm fjalë të mira për trajnerin e rivalëve të përjetshëm, kur pyetet se përse ai vërsëllet nga tifozët madrilenë. "Është diçka e pakuptimtë, por gjithsesi ne që luajmë në nivele të larta e dimë shumë mirë që tifozët harrojnë ato që kemi arritur dhe kërkojnë çdo ditë më shumë", ka thënë Messi, që më pas nuk e fsheh objektivin e skuadrës së tij, gjithmonë i njëjtë për "El Clasico". "Kjo ndeshje është speciale, e tillë është edhe çdo fitore", ka vijuar

sulmuesi argjentinas. Sfida e së mërkurës pritet t'i prishë ekuilibrat në garën për titull, pasi Barcelona dhe Real Madridi vijnë në këtë përballje me pikë të barabarta në krye të renditjes. "E rëndësishme është të luajmë ndeshjen dhe ta shijojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Në fund të fundit, si ne ashtu edhe Barcelona këtë kërkojmë. Këto janë ndeshjet që gjithsecili ëndërron të luajë. Një ndeshje e madhe futbollit, pjesa tjetër nuk ka rëndësi", ka thënë Zidane, duke larguar ekipin e vet nga presioni që ka rrethuar "El Clasico" e parë sezonal në La Liga.

Milwaukee ndalet pas 18 fitoresh radhazi

MILWAUKEE, 17 DHJETOR - Pas 18 fitoreve radhazi skuadra e Milwaukee është mposhtur me rezultat 120-116 nga Dallasi, një përballje në përgjithësi e dominuar nga miqtë. Ndeshja dhuroi emocione në fundin e saj, por Antetokounmpo, me 48 pikë e 14 rebounde, këtë herë nuk mundi ta evitonte humbjen. Për Dallasin u dalluan Seth Curry e Kristaps Porzingis me nga 26 pikë secili. Houstoni nuk përsëriti gabimin e dy javëve më parë dhe këtë herë fitoi me rezultat 109-107 ndaj San



Antonio në derbin teksan. Spurs dominoi në ndeshje, madje u shkëputë deri në 25 pikë (Aldridge 19 pikë e 13 rebounde), por gaboi në fund. Houstoni përmbysi gjithçka në minutat e fundit, duke triumfuar falë 31 pikëve e 10 reboundeve të Westbrookut dhe 28 pikëve të Hardenit. Fitoi edhe skuadra kampione e Torontos, që

mundi me lehtësi 133-113 Clevelandin (Siakam 33 pikë), sukses që mban ekipin kanadez në vendet e para në Lindje. Portlandi mposhti 111-110 Phoenixin, sukses që u vendos në sekondat e fundit (McCullum 30 pikë e Lillard 27), ndërsa Memphis triumfoi 118-111 ndaj Miamit (Valanciunas 21 pikë e 10 rebounde).

SHKURT

Neymari nuk do të largohet nga PSG-ja

Pavarësisht prej spekulimeve të shumta, braziliani Neymar nuk do të largohet nga Paris Saint-Germain në fund të këtij edicioni. E përditshmja "L'Equipe" raporton se gjasat janë të mëdha që Neymar të jetë pjesë e klubit francez edhe për edicionin e ardhshëm. "Pse të largohem nga PSG-ja? Nuk kam ndonjë arsye për një gjë të tillë. Unë jam parisien dhe do të jap 100 % nga vetja për ta ndihmuar ekipin. Jam i lumtur këtu", ka thënë Neymar.

Kean, afër Romës

Moise Kean duket se në afatin kalimtar të janarit do të largohet nga Evertoni, pasi nuk po arrin të përshtatet si duhet në Premier Ligë. "Daily Star" raporton se sulmuesi në fjalë do të rikthehet në Itali, kurse interesim për të ka shfaqur skuadra e Romës. Skuadra nga kryeqyteti italian është gati të ofrojë 30 milionë për ish-sulmuesin e Juventusit.

Flick: Përballjen ndaj Chelseat nuk e shohim si hakmarrje

Bayern Munchen e humbi finalen e Ligës së Kampionëve në edicionin 2011-2012 pas gjuajtjeve të 11-metërshave ndaj Chelseat, por trajneri aktual i Bayernit, Hans-Dieter Flick, ka thënë se nuk e sheh përballjen ndaj anglezeve në 1/8 e finales si hakmarrje për atë finale. "Në fazën e 1/8-ave nuk ka kundërshtar të lehtë. Chelsea është një klub që njihet botërisht. Objektivi ynë është të shkojmë në raundin tjetër pavarësisht prej kundërshtarit. Skuadra duhet të përballlet e qetë në të dyja takimet. Do të jetë një spektakël. Do të kërkoj nga djemtë të mos e shohin si hakmarrje pasi ndeshja nuk është e njëjtë. Është një takim i rëndësishëm për objektivat sezonalë dhe asgjë më shumë. Të gjithë mezi e presin duelin", ka thënë Flick.

Anceletti në bisedime me Evertonin

Vetëm një javë pas shkarkimit nga stoli i Napolit, Carlo Ancelotti mund ta marrë drejtimin e një tjetër skuadre. Sipas medieve angleze, italiani ka zbarkuar në Liverpool për ta dëgjuar ofertën e Evertonit, klubit që është pa trajner pas shkarkimit të portugezit Marco Silva. Ish-trajneri i Napolit është kontaktuar edhe nga skuadra e Arsenalit.

Drejt përmirësimit gjendjen shëndetësore të Schumacherit

Tifozët kanë qenë në kërkim të lajmeve për gjendjen shëndetësore të Michael Schumacherit që kur ai pësoi lëndim në tru nga një aksident skijimi. Përderisa familja e tij ka qëndruar e heshtur, mjeku i tij e ka thyer këtë heshtje dhe e ka zbuluar gjendjen shëndetësore të ish-kampionit të Formula 1. Michael Schumacheri është ende duke marrë terapi, që pritet të zgjasë deri në tre vjet. "Ai e ka një plan një deri në trevjeçar për shërim, për periudhën e rigjenerimit", ka thënë Jean-Francois Payen, mjeku që e konfirmoi i pari vitin e kaluar se legjenda e Formulës 1 nuk ishte më në komë. Payen, gjithashtu, zbuloi se ai rregullisht e viziton Schumacherin. "Unë ende e vizitoj atë dhe flas për familjen për çfarëdo përparimi që shoh", shtoi mjeku. Megjithatë, ai nuk pranoi të zbulojë më shumë hollësi, pasi që e respekton vendimin e familjes për ta mbajtur gjendjen e Schumacherit sekrete. Megjithatë, Payen shtoi se Schumacheri është në gjendje pozitive dhe po shkon drejt shërimit. Ai gjithashtu bëri me dije se bashkëshortja e Schumacherit, Corinna, është duke e bërë maksimumin për t'i ndihmuar bashkëshortit të saj të shërohet sa më shpejt, duke ia krijuar kushtet optimale për shërim. "Ajo menjëherë e dinte sa serioze ishte situata dhe e dinte rrugën e gjatë që e kishim para vetes. Ajo i sheh gjërat shumë qartësisht dhe është e gatshme të bëjë gjithçka për ta përmirësuar gjendjen e bashkëshortit".

REZULTATET

Detroit - Washington	119-133
Toronto - Cleveland	133-113
Houston - San Antonio	109-107
Memphis - Miami	118-111
Milwaukee - Dallas	116-120
Oklahoma - Chicago	109-106
Phoenix - Portland	110-111



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets



Ftesë për Ankand Publik
Rishpallje

Datë 17.12.2019

Referenca: AAPSK - 14/2019

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Mercedes Benz- Furgon, viti i prodhimit 2014 Dizel ngjyre e Bardhe me targa vendore	1 copë	18,750.00€		
2	Mercedes-Benz Sprinter 311-Furgon, viti i prodhimit 2008 Dizel ngjyre e bardhe me targa vendore	1 copë	5,250.00€		
3	Mercedes MB 100 DL-Furgon, viti i prodhimit 1991 Dizel ngjyre e Kuqe me targa vendore	1 copë	262.50€		
4	Mitsubishi Space Wagon 2000, ngjyre vishnje per pjese	1 copë/per pjese	225.00€		
5	Fiat Punto 1242, viti i prodhimit 2001 benzini ngjyre e kuqe, me targa vendore	1 copë	600.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 24.12.2019 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin nga nr. 1 deri ne nr 4 mund ta shikojnë me datë: 20.12.2019, prej orës 10:00-11:00 në Hapësirën Doganore në fshatin Hajvali KK Prishtinë, ndërsa pasuria në nr. 5 mund ta shikojnë me datë: 20.12.2019, prej orës 14:00-15:00 Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se,në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 016.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Alban Vitija, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Don Bosko" Prishtinë.

► Driton Boletini shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ndre Mjeda" Rakosh Istog.

► Fatmire Skender Dula, shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të UP-së, drejtimi Inxhinieri i Diplomuar i Arkitekturës.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

NJOFTIM PËR SHITJEN E STOKUT

ARCH LIGHTING .Sh.P.K. me numër fiskal: 600268834, njofton se për shkak të rrethanave të krijuara në kompani ofron shitjen e stokut me zbritje. Malli shitet me zbritje deri 55 % nga vlera kushtuese. Shitja bëhet me fatura të rregullta dhe pagesa bëhet përmes xhirollogarisë bankare. Oferta vlen 30 ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore. Të interesuarit mund të lajmërohen në këto kontakte:

E-mail: archlighting_ks@yahoo.com

dhe tel: +383-44-239-753.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/giejpuneshpejte